



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 108, tetor 2012

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## GJAKMARRJA SFIDË E KOHËS APO MJET PËR TË FITUAR? ...

Me datën 16 tetor 2012 u zhvillua "Kuvendi" i Avokatit të Popullit, me teme: "Gjakmarrja sfide e përbashkët". Kuvendi i zhvilloi "punimet" në mjediset e Hotel "Europa". Në këtë Kuvend, në mes të tjerëve morën pjesë: Presidenti Alfred Moisiu në pension; Avokati i Popullit, Igli Totozani; deputeti i Shkodres, Astri Beci; Artistja e Popullit, Tinka Kurti;



## Murosja e Marijes, çikës së Dukagjinit

Duhej që të murosej Rozafa, sipas legjendës, që të ngrihej keshtjella e Shkodres. Duket se legjenda u kthye në histori dhe kërkohet të martirizohet një çikë nga Dukagjini për të ndaluar vëllavrasjen e për të vendosur pajtimin. Kjo ngjarje shqetësoi mbarë opinionin shqiptar dhe lëvizjen qytetare, e cila filloi në sheshin Gjergj Kastriotin në Tiranë. Ata ndezën qirinj, vendosën lule dhe bënë homazhe në nderim të çikës së Dukagjinit, pra u ndez pishtari i pajtimit, vepër kjo humane dhe historike, sepse akti i parë historik i Gjergj Kastriotit, në



takim me princat shqiptar ishte pajtimi. Pra, ndalimi i vëllavrasjes dhe ashtu të bashkuar luftuan dhe fituan mbi otomanet. Ky pishtar bëri jehonë dhe gjeti përkrahje nga disa shoqata në rrethin e Shkodres, të cilat organizuan disa aktivitete për ti thënë "ndalim i vëllavrasjes në të errëta" në "mbrojtje të jetës".

## GRATË DUKAGJINASE GJYMTYRA MË E RËNDËSISHME E JETËS NË MALËSI

"MBIJETESA JONE KOMBËTARE, DEDIKOHET GRUAS SHQIPTARE"-FAIK KONICA

Gruaja dukagjinase brez pas brezi ka qene e mbrujtur me ato cilesi, tipare e vera te trevave ku ajo e kaloi jeten. Misioni i saj fisnik ka qene kultivimi te krijesa e saj te dashurise per jeten, per truallin, per fisin, per atdheun; te kultivoje ndershermerine, besen, bujarine e besimin per te ardhmen. Ajo ka qene pjesemarrrese aktive ne te gjitha proceset e jetes. Roli i saj ne harmonizimin e jetes familjare ka qene gjithmone i pazevendesueshem.

## KUJTIME NGA PUNA IME NË DUKAGJIN

Nga Isa Alibali

Duke diskutuar për problemet që lidhen me temën shumë aktuale "Integrimi – çeshtje botëkuptimi" botuar para shume kohësh edhe në gazetën "DUKAGJINI" të autorit Luigj Shyti, mendova t'i dergoj kësaj gazete disa mendime nga ana ime. Problemet që shtrohen në këtë artikull interesant, në përgjithësi janë pjesë e rëndësishme të jetës sonë të përditëshme, të bisedave mes njerëve të kategorive të ndryshme shoqërore, do të thosha deri edhe në çdo familje. Ndonëse kjo është një temë që kërkohet të zëbërthim më të plotë dhe të gjithanshëm, më të hapur dhe gjithëpërfshirës, në gazetën tuaj shprehën konceptet e drejta për këtë temë të rëndësishme. Duke theksuar se integrimi është çeshtje botëkuptimi ...



## PUSHKATIMI I 104 SHQIPTARËVE NË KAMPIN FAMEKQË TË PRISHTINËS

Me 23 tetor 1944, në dreke, si zakonisht bie bilbili dhe çanga, që binin papushim në mënyrë të zgjatur dhe alarmante, jo si heret e mëparshme. Ushtare dhe oficer naziste me shkopinj gome në duar vraponin drejt Prishtinës dhe me fytyrat e tyre të egersuara diçka paralajmëronin. ...

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\*



Nga poetët  
Martin Camaj  
dhe Frederik Rreshpja

REDAKSIA  
Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Florenc Buxha, Lulash Brigja

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:  
**GJERGJ LEQEJZA**  
Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

# GJAKMARRJA SFIDË E KOHËS APO MJET PËR TË FITUAR? ...

Me datën 16 tetor 2012 u zhvillua "Kuvendi" i Avokatit të Popullit, me teme: "Gjakmarrja sfidë e përbashkët". Kuvendi i zhvilloi "punimet" në mjediset e Hotel "Europa". Në këtë Kuvend, në mes të tjerave morën pjesë: Presidenti Alfred Moisiu në pension; Avokati i Popullit, Igli Totozani; deputeti i Shkodrës, Astri Beci; Artistja e Popullit, Tinka Kurti; Artisti i Merituar, Lazer Filipi; Z/V Ministri i Brendshëm, Nard Ndoka; Z/V Ministri i Drejtësisë; Përfaqësuesi i OSB-se në Shkodër; Konsulli i Italisë në Shkodër; kryetari i Pajtitimit Mbarëkombëtar, Gjin Marku; nga grupimi "Aleanca për Jetën", Arben Shala, Luigi Mila (ky dhe Sekretari i Komisionit për Drejtësi e Paqe në Shkodër, ishte në emër të Monsinjorit Angelo Massafro).

Kuvendin e hapoi dhe e drejtoi Mentor Kikia, i cili në mes të tjerave tha: "... Ky ligj i Mesjetës ... nuk zhduket as me një ligj nga kuvendi apo me një vendim qeverie ...".

Pastaj foli ish Presidenti Alfred Moisiu, i cili në mes të tjerave tha: "... janë bere dy pajtime për gjakmarrje, në të cilat kam marre pjese vete ... Komiteti i Pajtitimit ka punuar mire, ka punuar me përgjegjësi ...".

Artistja e Popullit, Tinka Kurti, në mes të tjerave theksoi: "... Anton Çeta ne Kosove ... Kanuni e nderon gruan ...".

Artisti i Merituar, Lazer Filipi, në mes të tjerave theksoi: "... falja e gjakut ... dhe reciton poemën e Pashko Vasës "O mjera Shqipni" ...".

Regjisori Vladimir Prifti, në mes të tjerave u ndal "... Ai që merre gjak duhet të dënohet me burgim të përjetshëm ...".

Më vonë e morre falen Z/Ministri i Brendshëm, Nard Ndoka, i cili në mes të tjerave jep disa tregues që bëhen për here të pare, si: "... 225 vrasje janë për gjakmarrje që nga viti 1998, ose 7.9 % e numrit të përgjithshëm të vrasjeve, që janë 2 848 vete. ... Të ngjuar janë 67 familje dhe prej tyre: në Qarku e Shkodrës, 48 familje; në e Qarkun e Kukësit, 13 familje; në Qarku e Lezhës, 4 familje; në Qarku e Tiranës, 1 familje dhe në Qarku e Durrësit, 1 familje ...".

Në fund e mori falen Z/V Ministri i Drejtësisë, i cili e filloi: "... Për të mos e politizuar ende nuk janë miratua propozimet ndryshuese të kodit penal ...".

Drejtuuesi Mentor Kërkojë nga të pranishmit, kush ka ndonjë gjë të veçantë, por të flas shkurtë se, nuk kemi kohe ...! Me këtë rast e morën fjalën disa, si: Tom Bregu, i ngjuar dhe në mes të tjerave tha: "... Ndoshta, po sa të dal prej këtu, mund të vritem pa pasur asnjë faj ..."; Luigi Mila, Gjin Marku, Aleksandër Kola, Ndue Sanaj, Antoneta Perja, e cila në mes të tjerave kërkoi: "... ju lutem të mos bëhen përpjekje të përfitohet nga shoqata të ndryshme ... ju lutem e ju lutem ..."; Liljana Luani, Gac Mark Toma e

ndonjë tjetër.

\*\*\*

Në pamjet e parë, del se shqetësimet për fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri jo vetëm janë të mëdha, por dhe përpjekjet për parandalimit e tij janë gjithashtu të mëdha, por në analizën tone përfundimet nuk dalin kështu, në të kundërt, e gjitha kjo fasadë është shumë përfaqësore dhe më shumë për SHOW.

"Kuvendi" u mbledh, me temën mjaft domethënëse, "Gjakmarrja sfidë e përbashkët" dhe aq më tepër që do ta organizonte Avokati i Popullit, Igli Totozani, në Shkodër. Në ftese, në mes të tjerave theksohet: "Institucioni i Avokatit të Popullit bashke me organizatat joq-

Shkodrës. Ata ishin nga Tirana dhe nuk e dimë se bënin pjesë në ndonjë shoqatë që shqetësohet për këtë çështje primitive në shoqërinë shqiptare. Ne, na u kërkua të flasim shkurt, kush ka dëshirë se, nuk kemi kohe!?"

Disa refleksione nga ky "Kuvend":

Së pari, në këtë "Kuvend" nga disa figura na doli se fenomeni i gjakmarrjes ka një moshe, dhe datëlindja e tij është në mesjetë... Madje, ndonjëri na recitoi dhe poemën e Pashko Vasos "Moj e mjera Shqipni" ... falja e gjakut është gjithë fisnike ... Ndonjë tjetër tha: ... kanuni e vlerëson gruan, kur ka hyre ajo në mes të burrave, nuk ka ndodhur vrasja ... na duhet një

kemi nevojë për folklorizma, as të bëjmë thirrje patetike: Ku janë këta apo ata?!, - çka e vene brezin tone në pozita inferiori. Edhe sot, në një nga TV nacionale, në mes të tjerave, njeri theksoi: "... Rilindësit kane qene më të mençur se jemi ne sot ...!?" Ja disa shembuj: "Thëniet e kthjella të kanunit, të gjitha sa lakonike aq kuptimplote, Imue nëpër rrymën e shekujve ma fort se vallet e këtij populli mijëra vjeçar ...", theksoi Berdadin Palaj, në revistën "Hylli i Dritës" të vitit 1924, kur shkruante për doket e zakonit të Dukagjinit. Kur ky kanu, i'u dha i përkthyer Baroni Clandius von Schwerin, profesor i historisë se ligjeve ne Universitetin e Miinchn-it, dha këtë gjykim: "...

ecësh e të jesh dikush, pa u marre me atë, që në këtë 100 vjetor ka domethënie të madhe ...

Së treti, Njeri tha se, Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar, ka luajtur rol te mire ne parandalimin e gjakmarrjes ... Pra, ato duhet të vijojnë të mbahen ende në një shoqëri demokratike, me shtetin ligjor dhe të së drejtës!? Një absurditet i vërtetë!

Profesori i universitetit të Vjenës, i te drejtës ndërnacionale, Bratoshi, shkruante: "E keqja më e madhe është bere kurdoherë në emër të së mirës. Institucioni i faljes me konnotacionin e qarte dhe të patjetërsueshëm të pranimit të së drejtës zakonore produktoi shume vrasës, inspiroi instinktët e dobëta njerëzore". Prandaj jemi kundër vijimit të punës së Shoqatave të pajtitimit të gjaqeve. Misioni i tyre duhet të mbyllet, se vijimi i tyre ka instalua dhe instalon tre precedentë të papranueshme: e para, krijimi i një "shteti" brenda shtetit demokratik, që është e papranueshme; e dyta, ngjalljen e strukturave që i kane shërbyer pushtesit osmano-turk, që roli dhe kompetencat e tyre janë mbyllur me 28 Nëntor 1912, me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë; dhe e treta, që është me e keqja, po edukojnë rininë për t'u kundërvënë shtetit ligjor, dhe për të jetuar e drejtuar me të drejtën zakonore, për të zgjidhur problemet me vetëgjyqësi. Këtë të fundit e vërteton pyetësori i bere nga Komisioni për Drejtësi dhe Paqe, me të rinjtë, që 82 % e tyre kane deklaruar se marrim gjak në baze të drejtës zakonore, kur këta fëmijë nuk e ka lexuar dhe aq më pak nuk dine ta interpretoje, por në mënyrë instiktive arrin në këtë përfundim. E dhimbshme, por kjo është e vërtetë.

Së katërti, në këtë "Kuvend", nga Z/Ministri i Brendshëm u dhane disa shifra shume të tronditshme: "... në vitet 1998-2012, në Shqipëri jane vrare 2848 vete, prej tyre 225 vete per gjakmarrje, dmth 7.9 % e tyre ... Familje të ngjuara 67 dhe persona të ngjuar 155 vete, sipas qarqeve: në Shkoder, 48 familje dhe 93 meshkuj, 21 femije dhe 2 studente të ngjuar; në Kukës, 13 familje dhe 16 meshkuj, 6 femra e 7 femije të ngjuar; në Lezhë, 4 familje dhe 4 meshkuj të ngjuar; në Tiranë, 1 familje dhe 1 mashkull të ngjuar; në Durrës, 1 familje, 1 femer dhe 3 femije të ngjuar.

Po, cila është e vërteta? Në vitin 2003, në internet jepej kjo shifer: Ne Shqipëri jane 50 000 femije jane të ngjuar. Në gazetën "Shekulli" të atij viti, shkruhej: "... jane 700 gra që kane mbetur të veja pasi burrat u janë vrare pikërisht për gjakmarrje ... në qytetin e Shkodrës janë të ngjuar 500 vete, janë pajtuar 100 familje ... janë 6 mije fëmijë të ngjuar ... vetëm në Shkodër janë 500



veritare, duke e konsideruar luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes si një nga prioritetet më të rëndësishme të punës së tij, thërret këtë Kuvend, i cili ka për qëllim diskutimin e përbashkët, sensibilizimin e shoqërisë mbi problematiken e rënde të gjakmarrjes, denoncimin me force dhe gjetjen e formave të reja efikase të luftës për çrrënjosjen e tij. Prania juaj në këtë aktivitet ..., është kontribut konkret në misionin e përbashkët."

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" e vlerësoi maksimalisht këtë ftese dhe u perfaqësua në këtë "Kuvend" me një pjesë prej saj. Madje dhe ishim përgatite seriozisht për të thënë mendimin tone, në pikëpamje historike, pse jemi në këtë gjendje dhe si mendojmë ne të dalim nga kjo gjendje. Në këtë Kuvend vinim pas tërheqjes së mendimeve të anëtareve të kryesisë, pas një veprimtarie të tilla të organizuar nga grupimi "Aleanca për Jetën", me teme: "Gjakmarrja plagë ende e pambyllur" e zhvilluar me datën 8 tetor 2012, nga e cila dolën mjaft mendime të vyera, të cilat do ti paraqitnim në këtë Kuvend.

Çfarë u pa në këtë Kuvend?! Ata që mbajtën kumtesa në kuvend, nuk ishin nga shoqëria civile e

Anton Çete ... Një tjetër lëvdoje punën e madhe që ka bere "Komiteti i Pajtitimit Kombëtar" ... madje, edhe unë kam marre pjesë në pajtimin e dy familjeve ...

Pra, një pjesë e të pranishmeve vinin ashtu, në tym dhe duke abuzuar pozicionin publik të tij apo te saj, fliste kote së koti, pa e ditur se ku done me dale. Prandaj jepnin mendime të tilla të dal boje, për të cilat shoqëria shqiptare nuk ka nevojë.

Kanuni i Leke Dukagjinit, nuk është drejta zakonore për hakmarrje apo gjakmarrje, që ka filluar në mesjetë. Hakmarrja, vrasja e gjakmarrja e ka zanafillën e vet që kur u formësua njeriu. Për to u mendua, që kur u shkrua me një degë peme në hirin e vatrës, apo me thëngjill apo pupël shpendësh dhe deri në të sotmen kur elektronika ka arritur lartësi të paimagjinueshme.

Madje, emrin këtij kanuni "Leke Dukagjini", ende nuk e kemi të qarte plotësisht se, kur e mori apo kur e pagëzuan me te. Ka të dhëna, që këtë pagëzim e beri Faik Konica me At' Gjergj Fishtë, kur At' Gjeçovi po punonte për mbledhjen e tij, në Gomsiqe, ku Gjeçovi ishte famullitar! Mendojmë se, kjo çështje nuk duhet të ketë moshe siç mendohet nga disa deri tani. Sot, nuk

janë ligje krejt t' interesantshme, ndoshta më të vjetrat ligje t' Evropës", fq. 387, "Hylli i Dritës", të vitit 1942. Ne qofte se do të ecim sipas këtyre mendimeve, ne vetëm fundosemi çdo dite e më tepër që kalon. Dikush thotë: "Ju shqiptaret keni kushtetutën e pare në bote ... madje disa thonë se, kjo kushtetute ka lindur në Dukagjin ...".

Intelektuali nuk mund të ketë mendime te tilla inferiori. Njeriu, nuk kthehet prapa, njeriu dhe në veçanti intelektual nuk duhet të mbes peng e së kaluarës. Mbetja peng e së kaluarës tregon varfëri në dije, në mendime, në arsyetime, dhe në vend që të ecën përpara, mbetemi prapa.

Së dyti. Në këtë takim doli se media ka rol të madh edukativ. Po, media ka rol të madh në të gjitha fushat, në veçanti në fushen e edukimit, por një pjesë nuk po e luajnë rolin e tyre informues dhe aq më pak atë edukativ. Çfarë po ndodh sot?! Në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, Televizorët janë mbushur me telenovela turke dhe çfarë është më e keqe se, ato janë me plote krime nga më çnjerëzoret, jepen në mes të ditës dhe në këtë mënyrë edukojmë fëmijët me mendimin e gabuar se, dhuna është më e mundshme të



# Murosja e Marijes, çikës së Dukagjinit

Duhej që të murosesh Rozafa, sipas legjendës, që të ngrihej keshjtjella e Shkodres. Duket se legjenda u kthye në histori dhe kërkohet të martirizohet një çikë nga Dukagjini për të ndaluar vëllavrasjen e për të vendosur pajtimin. Kjo ngjarje shqetësoi mbarë opinionin shqiptar dhe lëvizjen qytetare, e cila filloi në sheshin Gjergj Kastriotin në Tiranë. Ata ndezën qirin, vendosën lule dhe bënë homazhe në nderim të çikës së Dukagjinit, pra u ndez pishtari i pajtimit, vepër kjo humane dhe historike, sepse akti i parë historik i Gjergj Kastriotit, në takim me princat shqiptar ishte pajtimi. Pra, ndalimi i vëllavrasjes dhe ashtu të bashkuar luftuan dhe fituan mbi otomanet. Ky pishtar bëri jehonë dhe gjeti përkrahje nga disa shoqata në rrethin e Shkodres, të cilat organizuan disa aktivitete për ti thënë "ndal fenomeneve të errëta" në "mbrojtje të jetës". Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe gazeta e saj shkruan rreth kësaj ngjarjeje; në artikujt e saj i bëhet thirrje popullit që të bëhen promotorre të ndalimit të vrasjes dhe të gjakmarrjes dhe të ngrihen kundër veprimeve primitive e të kritikohet qëndrimi indiferent i njerëzve dhe kryesisht kritikohet shteti për paafësinë në mbrojtje të jetës së njerëzve.

Ndërsa nga ana psikologjike shkruajnë se e gjithë shoqëria jonë është në krizë dhe kërkohet ti jepej fund këtyre veprimeve që dëmtojnë imazhin e shoqërisë tanë. Këto veprime e kanë origjinën që heret në lashtësi dhe kanë ngelur si një rudiment, një plagë kanceroze në trungun e Malësive të Veriut dhe që ka sjellë vdekje më shumë se çdo pushtues që ka kaluar në trojet tona. Shoqëria jonë është përpjekur që në lashtësi që të vërë disa rregulla të cilat janë quajtur kanune që në fjalorin arabo-turk dmth ligj. Në të drejtën tonë zakone fjalë zakone në fjalorin sllavo-bullgar dmth ligj. Tek ne kanë vepruar disa kanune si: Kanuni i Maleve ose i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skendërbeut, i Kurbinut, i Labërisë e i Kurveleshit. Kanuni i Lekë Dukagjinit është thelbi i të drejtës zakonore dhe përfshin hapësirë të gjerë e ka qënë më konservator. Sipas kanuneve

janë mbledhur kuvende që kanë vzhduar deri në vitet 20 të shekullit të kaluar. Shpallja e pavarësisë në vitin 1912 nuk bëri që qeveritë e dala të nxirrin ligje shtet-formuese gjer në vitin 1924. Me vendosjen e rregjimit monarkist, shteti nxorri ligje që ndalojnë vetëgjyqësinë, mblodhi armët e këtë bënë që të frenohen vëllavrasjet nga çdo motiv që nise-



shin. Faktikisht me këto ligje pushuan së vepruari kanunet sepse shteti ka vetëm një kushtetutë. Megjithatë misionaret e pajtimit për probleme të ndryshme lejoheshin të vazhdonin punën e tyre humanitare. Edhe në atë kohë edhe kleri katolik organizoi lëvizjen jezuite që shkuan në malësitë e Veriut për pajtim e falje gjaku, por një popull i tëri pothuajse analfabet dhe që literatura dhe liturgjitë ishin në gjuhën latine dhe disa klerikë vinin nga Europa, ishte e vështirë të kuptohej drejt doktrina e faljes dhe pajtimit, prandaj dhe lëvizja nuk solli rezultatet e dëshiruara. Kjo tregon që shteti që zbaton ligjet, e ndalon vëllavrasjen. Mbas çlirimit të Shqipërisë shteti nxorri ligje dhe kushtetutë që të mbrohej jeta e njeriut, kjo ndaloi çlloj lloj vetëgjyqësie ngaqë ligji vepronte

familje të përfshira në gjakmarrje ... rreth 2 000 fëmijë të ngjuar ... në vitin 2004, një shoqate e pajtimit deklaronte: Në zonën e Dukagjinit janë 120 femije të ngjuar ... Në gazetën "Tirana Observer" e datës 9 tetor 2012, në mes të tjerave shkruhet: "... Nga të dhënat e fundit që u publikuan në konferencën e djeshme në Shkodër vetëm në 22 vitet e fundit kanë ndodhur mbi 5 200 vrasje, me mbi 5 700 viktima. Rreth 1200 persona janë të ngjuar, mes të cilëve rreth 130 fëmijë, çka i jep dimensione të rënda dhe jashtë kornizave kanunore fenomenit të gjakmarrjes". ... Në gazetën "Telegraf" e datës 11 tetor 2012, në mes të tjerave shkruhet: "... Në emër të Gjokmarrjes, gjatë 20 vjetëve të fundit janë ekzekutuar 5 700 viktima"! A më dëgjove mirë? 5 700 shqiptarë kanë ikur në botën tjetër! Thjesht shifër e frikshme?..."

Ka dy versione: E para, disa organizata për

qëllime përfitimi japin të dhëna të tilla, që jo vetëm të çorodisin, por janë dhe skandaloze, të bëjnë ti thuash vetes: Ku jam? Dhe që këto organizata e bëjnë këtë për qëllime përfitimi, është e vërtetë. Një zonje në këtë "Kuvend" e theksoj disa here: "... Ju lutem mos punoni për SHOW me qëllime përfitimi ... është turpshme ...", po kujt ja tha?!

Së pesti, shume flasim për gjakmarrjen dhe mire bëjmë, por nuk flasim për atë që e sjelle gjakmarrjen, nuk flasim për vrasjen aq sa duhet dhe që duhet parandaluar. Gjate viteve 1998-2012 janë vrare 2848 vete, prej tyre 225 vete janë vrare për gjakmarrje, po 2 623 vete për çfarë janë vrare, te cilat përbejnë 92.1% të gjitha vrasjeve?! A nuk janë edhe këta njerëz që u është këputur jeta në mes? Duke shkruar më tej duhet pyetur se sa për këto vrasje ndiqen nga policia, prokuroria, gjykatat, sa marrin vrasësit dënimin e merituar, sepse një gjë e tillë do të ulte shumë

ndaj kujtdo m\pa mëshirë. Kjo bëri që vetëgjyqësia, gjakmarrja të zbresin thuajse në zero, por edhe atëherë misionaret e pajtimit, gjykatat e fshatave e të lagjeve vepronin për ngjarje të thjeshta dhe ndihmonin në edukimin e njerëzve. Me ndryshimin e sistemit në fillim të viteve 90, u vendos pluralizmi demokratik që solli jë demokraci formale. Hapja me botën e jashtme, pra kalimi nga izolimi tek hapja (nga ksenofobia tek kozmopolitizmi) përveç anëve të mira solli edhe probleme për shoqërinë tonë. Vendosja e një demokracie formale nga disa lider politikë liberalo-anarkist dhe kjo bëri që të vërshojnë tek ne ide dhe veprime anarkiste dhe anti-demokratike. Pati edhe ndonjë lider që i fetishizonte ligjet e vjetra: Kanunin e Lekë Dukagjinit. Këto veprime vulgare nxitën elementët e paformuar dhe keqbërës që të kryenin akte, të bënin veprime kriminale dhe tek ne fenomene vëllavrasjeje, trafikime, grabitje, prostitucioni dhe fenomene të panjohura nga shoqëria jonë në atë edhe fetishizimi i ligjeve të vjetra është i papranueshëm sepse ato përfaqësojnë kohën e feudalizmit e të parrmendës dhe bien në kundërshtim me kulturën demokratike.

Akoma më keq ishte hapja e depove të armatimit, e cila bëri që armët të bien në duart e njerëzve të paditur e të papërgjegjshëm. Kjo bëri që kurba e trimave të rritej dhe pasojat e saj do të ndihen edhe në dekadat e ardhshme.

Ligjet që bëjnë njerëzit (ato juridikë) edhe kushtetuta, ato nuk janë asnjëherë të përkryera qofshin edhe ato të vendeve të Beneluksit që janë Mesi i Artë i Demokracisë në veprim. Edhe ato përsosën vazhdimisht në raport me kohën dhe zhvillimin progresiv. Në këtë kuptim, edhe fetishizimi i lidereve politikë është i padrejtë dhe i dëmshëm. Përvoja historike tregon se liderët demokratikë janë shndërruar në diktatorë psh, revolucionin demokratik francez e udhëhoqi Robespieri, ndërsa Revolucionin anglez e udhëhoqi Oliver Kromuell, por këto të dy u shndërruan në diktatorë, e si pasojë përfunduan në gjyotinë; kjo sepse popujt e qytetëruar demokratë nuk pranojnë diktatorë. Tek ne gjatë kësaj periudhe të një demokracie formale e të brishtë e mungesës së shtetit ligjor bëri që tranzicioni të jetë i tejzgjatur, qeveritë pavarë-

sisht se kanë nxjerrë ligje, institucionet nuk veprojnë për zbatimin e tyre, si pasojë ndodhin edhe krime vëllavrasje për motive të ndryshme. Është për tu përmendur puna e institucionit të avokatit të popullit, i cili evidenton dhe ndihmon në parandalimin e veprave antiligjore dhe kërkon nga shteti zbatimin e ligjeve dhe ka kritikuar qeverinë për qëndrime indiferente. Qeveria të vendosë për ulla e lajthia, parlamenti të bëjë replika, por edhe për djem e çika që vriten, të mendojnë..

Në këtë vështrim edhe mediat tona kanë trajtuar probleme të ndryshme, janë ndalur tek kronikat e zeza duke i bërë më shumë bujë disa ngjarjeve që kanë ndikuar negativisht tek njerëzit tanë. Mediat, në të ardhmen duhet të luajnë rol edukativ dhe patriotik dhe të trajtojnë probleme të kulturës demokratike, të paqes e pajtimit, mes njerëzve kështu edhe poetët e shkrimtarët e rinj dhe rapsodët popullore duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi problemeve të paqes, të pajtimit që janë në shërbim të popullit. Kërkohej që e gjithë shoqëria jonë të shërbejë si misionare e pajtimit duke filluar që nga familja, me fëmijët, nënat bashkë me qumështin e tyre ti ushqejë fëmijëve dashurinë për jetën e njerëzit. Shkollat duhet të luajnë rolin e tyre si edukatorë, kështu edhe shoqëria në punë e kudo, të luajë rolin e misionarit.

Lëvizjet e mëdha demografike kanë bërë që të ndryshojnë struktura e shoqërisë e sidomos në qytete ku janë krijuar bashkësi të mëdha. Kjo kërkon më shumë dialog, tolerancë dhe sjellje të kulturuar në marrëdhëniet mes njerëzve. Në këtë vështrim roli i shoqatës "A Dukagjini" dhe me punën e mirë të kryesisë, veprimtaria e saj po ndihet gjithnjë e më shumë dhe po vlerësohet nga opinionin shoqëror. Ajo shpreh edhe mbron interesat e komunitetit, në të ardhmen duhet të kontribuojë edhe më shumë nëpërmes njerëzve të saj që bëjnë pjesë në organet legjislativë dhe ekzekutive dhe në institucionet e shtetit duke kërkuar dhe vënë më shumë para përgjegjësisë shtetin për mbrojtjen e jetës së njerëzve.

Ngjarja dramatike e Marijes, çikës së Dukagjinit duhet të shndërrohet në një simbol shprese e pajtimi si për Dukagjinin shtu edhe gjithë Shqipërinë dhe në rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë të jemi të bashkuar në një festë, në një tervese dhe me një besë.

Nga Pjetër DELIJA

gjakrat e familjeve të viktimizeve, do të jepte mundësi me shume besimit ndaj shtetit, më shume besimit ndaj strukturave të drejtësisë dhe do të jepte më shume mundësi të parandaloheshin gjakmarrjet.

Së gjashti, në këtë "Kuvend" doli dhe mundësitë që janë për të parandaluar vrasjen e gjakmarrjen, dhe për këtë janë vetëm dy rrugë: Edukimi dhe shteti. Të dy këta duhet të kryejnë detyrën e tyre. Përveç vrasjeve që u evidentuan në këtë "Kuvend" nga strukturat e shtetit që ishin tronditëse, por dhe ajo që paraqitem se, në zonën e Dukagjinit, në 162 vjet të pushtimit otoman, 1747-1909 janë vrare 82 vete; ndërsa në vitin 1991-2012, në shtetin demokratik janë vrare 144 vete dhe nder to, 15 femra, e cila i tronditi pjesëmarrësit, doli që shteti nuk po e kryen detyrën dhe jemi në gjendje anarkie. Na vjen mire apo nuk na vjen mire, kjo është gjendja dhe prej kësaj duhet të dalim, dhe një here, me

kryerjen e detyrës nga edukimin dhe shteti, organizatat e shoqërisë civile kane detyrën e sensibilizimit të gjendjes dhe jo të marrjes përsipër të pajtimit, në themel të cilës janë metoda arkaike, primitive.

\*\*\*

Pavarësisht këtyre probleme që nxorëm në analizën tone, diçka u bë, Institucioni i Avokatit të Popullit e ka filluar me shqetësim dhe me besim të përballet me këtë fenomen, me fenomenin e gjakmarrjes, që tani është mbare shoqërisë Shqiptare dhe u larguam nga ky "Kuvend", me shpresën se diçka do të behet më mire drejt së ardhmes, drejte emancipimit shoqëror dhe sa më larg këtyre mentaliteteve të vetëgjyqësisë, të mentaliteteve të një shoqërie primitive, duke rrite më shume besimin ndaj strukturave të shtetit, ndaj strukturave të drejtësisë.

Nga Ndue Sanaj,  
Luigj Shyti

## KONFERENCE SHKENCORE

Për dy ditë me rradhë në Akademin e Shkencave dhe te Arteve të Kosovës, u zhvillue konferenca shkencore: "Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas", organizuar nga Akademin e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Instituti i Historisë Prishtinës.

Merrin pjesë delegacione të ardhura nga Shqipëria, Kosova, Mali Zi, Maqedonia, Turqia, Hungaria.

Punimet e kesaj konferenca u drejtuan:

- Prof. Dr. Akademik Hivzi Islami, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

- Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, Drejtor Institutit Historisë Prishtinës.

- Prof. Dr. Akademik Beqir Meta, Drejtor Institutit Historisë Tiranë.

- Prof. Dr. Valentina Duka, Tiranë.

Pas himnit te Flamurit, në fjalën e hapjes Prof. Dr. Akademik **Hivzi Islami**, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nder te tjera theksoj: "Jubileu i madh, 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, dhe jubileu i 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, janë edhe një moment për ryshqirtimin e historisë, me c'rast ngjarjet dhe personalitetet historike do të interpretohen dhe vlerësohen nga këndvështrimi objektiv shkencore. Këto dy jubile janë gjithashtu një rast që gjakftohtë, pa emocione e patetikë, të nxjerrin mësimet nga pikat e pësimeve e dështimeve të qeverisjeve në të dy anët e kufirit dhe të reflektojmë për një qeverisje racionale e produktive dhe prespektive të sigurt evropatlantike".

Përshtetja nga Prof. Dr. Akademik **Gudar Beqiraj** kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u ndoq me vëmendje, i cili ndër të tjerat tha: "Eshhtë nder dhe kënaqësi e vecantë për mua që t'i sjell konferencës suaj përshtetjet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe njëherësh të falënderoj organizatorët për ftesën. Sot në këtë sallë jeni mbledhur shkencëtarë nga trojet shqiptare me synimin fisnik për të shënuar 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, në Vlorë me 28 Nëntor 1912, dhe për të hedhur dritë përmes studimeve tuaj në proceset historiko-politike e kulturore që cuan në realizimin e kesaj ëndrre shekullore, duke hedhur vështrimin në këta njëqind vjet, mbushur me ngjarje madhore për shqiptarët brenda dhe jashtë shtetit shqiptar të cunuar nga vendimet e diplomacisë evropiane. Me gjithë këto

zhvillime dramatike fitorja e pavarësisë së Shqipërisë dhe fitorja e pavarësisë së Kosovës, gati një shekull më pas, dëshmojnë se nuk mund të ketë forcë në botë që të arrijë ta varrosë ëndrrën e lirisë së një populli, dhe as të mohojë të drejtën e tij për të ndërtaur jetën e vet në shtetin e vet të pavarur".

Prof. Dr. Akademik **Beqir Meta**, Drejtor Institutit Historisë Tiranë nder te tjera theksoj: "Si vendi më i vogël, më i varfër dhe më i dobët i Ballkanit, fati i Shqipërisë u ndikua fuqimisht nga forcat jashtë të saj. Lufta për të drejtën e ekzistencës si komb-shtet, ndërkohë



që fqinjët e Shqipërisë përpiqeshin të nxirrnin në pah faktorët përcarës, pati ndërlikime të rëndësishme. Ajo bëri që të harxhoheshin burime të konsiderueshme, duke zhvilluar betejat politike, diplomatike e propagandistike jashtë vendit, vecanërisht në Lidhjen e Kombeve dhe në Gjykatën Ndërkombetare, të cilat pengonin projektin për konsolidimin kombëtar brenda vendit. Problemet e kufijve që u keqësuan nga qëndrimi i papajtuësëm i Athinës dhe Beogradit, i shterën financat e vendit dhe bënë që Shqipëria të mbetej pezull në prag të falimentimit".

Prof. Dr. **Jusuf Bajraktari**, Drejtor Institutit Historisë Prishtinës në kumtesën e tij solli fakte të reja: "Prishtina paraqiti në emër të Shqiptarëve një memorandum me 14 kërkesa, në të cilat përfshihej emërimi në Shqipëri i nënpunësve vendas, mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e Shqipërisë, zhvillimi

i bujqësisë e i tregëtisë, falja e përgjithsme për pjesëmarrësit në kryengritje, cka len me kuptue se po të realizoheshin këto kërkesa të parashruara hidhëshin themelt e një Shqipëri autonome. Qeveria nuk dha përgjigje, prandaj kryengritësit kosovar marshuan drejt Shkupit, dhe me 12 gusht 1912 e shtinë në dorë qendrën e Vilajetit të Kosovës".

Prof. Dr. Akademik **Pajazit Nushi**, Prishtinë, mbajti kumtesën mjaft interesante: "Mendimi akademik dhe urrejtja serbe ndaj shqiptarëve"

Prof. Dr. **Emine Bakalli** Prishtin, lexoj kum-

tesen: "Revolucioni Nacional Shqiptar i vitit 1912". Prof. Dr. **Bilgin Çelik**, Stamboll, ligjroj kumtesën: "Rrethanat ndërkombëtare dhe Pavarësia e Shqipërisë". Prof. Dr. **Valentina Duka**, Tiranë, gjatë referimit të kumtesës: "Ismail Qemali dhe institucionet ndërkombëtare qe vepronin në Shqipëri gjate vitit 1913", pati larmi tek akademikët.

Prof. Dr. **Arpod Harmjah**, Hungari referoj kumtesën: "Politika e Hungarisë ndaj Ballkanit midis dy luftave botërore". Prof. Dr. **Ferit Duka**, Tiranë ligjroj: "Faktorët e përcarjes dhe regresit në Shqipërinë e pavarur-Esat Toptani"

Prof. Dr. **Frashër Demaj**, Prishtinë mbajti kumtesën: "Qendrimi i diplomacisë së Fuqive të Mëdha lidhur me kërkesën e Serbisë për daljen në Detin Adriatik"

së Kosovës, etj.

Gjatë diskutimeve u theksua se është e nevojshme që të bëhet një koordinim më i mirë i punës në mënyrë që të mos mbivendosen veprimtaritë e atyre aktorëve dhe faktorëve që veprojnë në Alpet Shqiptare. U vlerësua me të drejtë puna mjaft e mirë e zhvilluar nga B3P-Albania në bashkëpunim me B3P-UK në veçanti për organizimin e programeve verore në Theth dhe në Kelmend. U evidentua në mënyrë të veçante puna e Presidentes se B3P-UK zonjës Antonia Yong, duke e quajtur një E.Durham të kohëve moderne.

Gjatë diskutimeve u dhanë mendime për shtrirjen më shumë të pjesëmarrësve në veprimtaritë e B3P – Albania, bashkëpunimi midis OJF apo fondacioneve të ndryshme, transparenca e veprimtarive, fondeve e mbledhjes dhe shpenzimeve të tyre, etj. U vlerësua me të drejtë korrektësia dhe transparenca në evidentimin e mbledhjes dhe shpenzimit të fondeve nga B3P, sepse siç u tha aty ka të dhëna nga terreni që persona nën maskën e ndonjë OJF enigmë nuk dihet se si mbledhen dhe si shpenzohen fondet, nuk identifikohen zyrtarisht, sillen si hije nëpër zona të ndryshme të vendit duke bërë propagandë sikur ato para që shpenzon janë personale, etj.

Antonia Yong theksoj punën që bën dhe do të bëjnë në të ardhmen B3P për mbrojtjen

Prof. Dr. Akademik **Marenglen Verli**, Tiranë mbajti me sukses kumtesën e tij: "Çeshtja e Kosoves dhe Shqipëria gjatë vitit 1918-1939".

Prof. Dr. **Fehmi Rexhepi**, Prishtinë, lexoj: "Qëndrimet e forcave politike në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore".

Prof. Dr. **Ana Lalaj**, Tiranë, u ndal në kumtesën e saj: "Britanikët për Kosovën brenda apo jashtë shtetit shqiptarë gjatë viteve 1941-1945".

Dr. **Teqi Kurti**, Tiranë, pati mjaft sukses në kumtesën e tij gjatë interpertimit: "Qendresa e shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve 1913-1914 sipas shtypit në Shqipëri".

Dr. **Sefer Tahiri**, Shkup, foli për: "Kontributi kombëtarë i gazetës "SHKUPI".

Dr. **Fehari Ramadani**, Tetovë, ligjroj: "Shkollat astro-hungareze në Vilajetin e Kosovës në vitet 1911-1912".

Prof. Dr. **Isa Bicaj**, Prishtinë: "Vendosja e pushtetit malazez në viset e pushtuara 1912-1913".

Dr. **Skender Hasani**, Shkup, foli me mjaft pergjegjësi dhe kompetenca rreth kumtesës: "Përpozimi i Bertholdit i vitit 1912 për çeshtjen shqiptare sipas shtypit bullgar".

Prof. Dr. **Agim Zogaj**, Prishtinë, mbajti kumtesën: "Çeshtja e Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1941-1948".

Prof. Dr. **Arsim Bajrami**, Prishtinë solli në kumtesën e tij që mbajti fakte të reja, të cilat u mirpritën: "Aspektet legale dhe kushtetuese të Pavarësisë së Kosovës".

Prof. Dr. **Ilira Çausi**, Tiranë; Prof. Dr. Akademik **Esat Stavileci**, Prishtinë; Dr. **Syl Ukshini**, Prishtinë, Prof. Dr. **Drita Gunga**, Prishtinë; Prof. Dr. **Iljaz Rexha**, Prishtinë; Dr. **Edita Tahiri**, Prishtinë; Gjeneral **Agim Çeku**, Prishtinë; Dr. **Rexhep Osmani**, Prishtinë; Prof. Dr. **Sulltane Ukaj**, Prishtinë; Prof. Dr. **Izber Hoti**, Prishtinë; Prof. Dr. **Muhamet Mustafa** dhe Dr. **Lumir Abdixhiku**, Prishtinë; Dr. **Fitim Rifati**, Prishtinë; Prof. Dr. **Violeta Nushi**, Prishtinë; Dr. **Parim Kosova**, Prizren; Dr. **Sabit Sylja**, Prishtinë; Dr. **Petrit Gashi** lexuan kumtesat e tyre me mjaft pergjegjësi.

Kjo Konferencë Shkencore dy ditore u ligjeruan 30 kumtesa, duke sjellur fakte të reja në prag të 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Në fund të kesaj Konferencë, Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, Drejtor Institutit Historisë Prishtinës, dha perfundimet e punimeve te kesaj Konferencë dhe shtroj detyra të rëndësishme që dalin përpara dhe që duhet të ketë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Instituti i Historisë të Prishtinës.

Nga Ibrahim HAJDARMATAJ

## VEPRIMTARI TË "B3P – AIBANIA" NË SHKODËR

Nën drejtimin e shoqatës "Projekti i Parkut Ballkanit te Paqes – Albania", në bashkëpunim me "Projektin Parku Ballkanit i Paqes ne Mbreterine e Bashkuar" me datën 12. 09. 2012, në mjediset e Hotel "Colosseau" u zhvillua një takim midis grupeve të interesit në zonat e mbrojtura në Alpet Shqiptare. Merrnin pjesë Presidentja e "B3P-UK" Antoina Yong, veprimtarë nga Amerika, nga Koreja e Jugut, veprimtarë nga Kosova, përfaqësues nga Bashkia Shkodër dhe Këshilli i Qarkut, përfaqësues nga disa OJF në Shqipëri, midis të cilëve edhe një grup nga shoqata "Atdhetare-Dukagjini". Është me vend që të theksojmë pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës. Ky ishte takimi i dytë në këtë kuadër.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të diskutohen mënyra dhe mundësi për një bashkëpunim më të frytshëm për ngritjen më lart të punës për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin në zonën e Alpeve Shqiptare. Mjaft serioze ishte përgatitja dhe drejtimi i kesaj veprimtarie nga Arian Gjura, drejtues i B3P-Albania, diskutimet dhe mendimet e Përfaqësuesit të GIZ Ismail Beka, përshëndetja e përfaqësuesit të

Bashkisë Shkodër Gentian Mema, ndërhyrjet dhe mendimet e përfaqësuesve të Qeverisë



edhe të diveristetit kulturor të zonave ku vepron.

Gjatë diskutimeve u theksua që zona e Alpeve Shqiptare duhet bërë e mundur që të mos shpullohet, të bëhet e mundur që këta njerëz të mund të jetojnë në kushte normale. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve, urave, shtigjeve, përmirësimi i kushteve të jetesës, përmirësimi i kushteve të akomodimit të turistëve dhe i kulturës së shërbimit e komunikimit, nxisin zhvillimin e vendit në përgjithësi dhe të turizmit në veçanti. Kjo është me shumë rëndësi.

Nga Korespondenti i gazetës "DUKAGJINI"

## GRATË DUKAGJINASE GJYMTYRA MË E RËNDËSISHME E JETËS NË MALËSI

“MBIJETESA JONE KOMBËTARE, DEDIKOHET GRUAS SHQIPTARE”-FAIK KONICA

Gruaja dukagjinase brez pas brezi ka qene e mbrujtur me a cilisi, ti-pare e vera te trevave ku ajo e kaloi jeten. Misiojoni i saj fisnik ka qene kultivimi te krijesa e saj te dashurise per jeten, per truallin, per fisin, per atdheun; te kultivoje ndershermerine, besen, bujarine e besimin per te ardhmen. Ajo ka qene pjese-marrese aktive ne te gjitha proceset e jetes. Roli i saj ne harmonizimin e jetes familjare ka qene gjithmone i pazevedesueshem.

Ne kete shkrim, natyrshem mund te permendesh dhjetera e dhjetera gra nga çdo fshat i Dukagjinit, te cilat me punen, sjelljen e moralin e larte te tyre, ia kane zbardhur faqen vetes, familjes, fisit e malesise. Ato meritojne shumenderime, respekt e mirenjohje per rolin e tyre si bartese te jetes njerezore. Si edukatore natyrale e femijeve, si zemra e shpirti i shtepise. Si te gjitha grate shqiptare, veçohen ato te malesive per veshtiresite e medha qekane perballuar duke ia buken shkembim me force, duke bere qe edhe atje te “mbije lulja mbi gure”, duke lindur e rritur sokola e sokolesha per vendin.

Ne kete shkrim mendoj qe te ndalem shkurtazi per tri sokolesha, te cilat ia kane zbardhur faqen malesise. Ato kane bere histori e unne po perpiqem te heq pak pluhur harrases nga emri i ndritur i tyre:

\*Lula-nena e Deli Pjetres se Pjollit! Lula nje grua burrneshe e radhe, trime e me karakter te forte,

qe vleresonte nderin si gjene me te shtrenjte e qe nuk lejonte me shkele mbi te qofte edhe djalin e saj te vetem. Ajo si edhe shume te tjere besen e kishte simbol te te gjitha virtyteve qe gezonte malesori yne, kuror e tyre. Besa e 7 shaljanëve eshte bere si legjende, se si vendosen ata me dhenejeten duke luftuar ne sarajet e Vezirit te Shkodres. Prej asajbeteje, Deli Pjetra mbeti gjalle, vetem ai. Kthimi i tij ne Shale, per te tregua se çka u be ne Keshtjellen e Shkodres, nena e tij, Lula nuk u gezua, pse djali ishte gjalle, i vetem, pa shoket!? “Pse ke ardhje, ku i ke lane shoket, per ty djale i prefsha floket!” - i thote Nena Lule. Veç nje grua, nje nene e madhe si kjo mund t'i thoshte keto fjale, te cilat nga i biri u vleresuan si njemallkim per te, ne qofte se nuk kthehej atje ku mbeten shoket e tij, per t'ua marre hakun. Dhe Deli Pjetra u kthye ne Keshtjelle, luftoi si burrat, si hero i vertete, me bekimin e nenes se tij.

Kane kaluar mbi dy shekuj nga kjo kohe, por Lula e famshme, mbetet e lavdishme ashtu si djali i saj e shoket e tij. Kenga popullore e shtateshaljanëve qe ishte si nje himn lavdie, e ka perjetsuar kete nene te madhe si pjese e atyre qe dhane jeten ne Keshtjelle. Shekujt e kthuen ne mit besen, e cila i mbajti ne kembe, krenare e te palekundur ne mbrojtje te Lirisë te maleve tona.

\*Mire Mushakja-grua e Mark

Sadikut! Mire MUshakja, bije e gjonpepajve te Nikajve, nga dera e permendur e Hajdar Ahmetit, ishte nje grua fisnike e me karakter te forte. Ajo pati fatin e madh te mar-tohet me mark Sadikun e Shales!

Ne vitin 1910, kur Marku ishte koçak, Mirja do te shkonte ne gjini per festen e Shmasqanit. Koçaket kerkoheshin e famijet e tyre mbaheshin ne mbikqyrje. Kete rast te Mires e merr vesh Mustaf Efendi, zyrtar turk, i njohurne Dukagjin, i ngarkuar te ndjeke e te ndeshkoje koçaket e vendit. Per t'a detyruar Markun qe te dorezohet, Mustafa e zaptite e hafijet e tij, menduan qe t'i marrin peng gruan, Miren me djep ne shpine gjate rruges per ne Nikaj, pasi te kaloje qafen e Ndermajes. Por zyrtari turk ishte gabuar ne planin e tij edhe pse Mirja u zu “rob”. Te paret tane, na kane mesuar se punet e veshitira i zgjidhin burrat e mençur, por jeta vertetoi se shume gra te mençura ikane zgjidhur ne menyren me te mire problemet apo kurthet e grackat e ngritura ndaj tyre. Nje nga keto ishte edhe Mirja, shembulli i saj flet vete. Gjate rruges ajo me gjakftohetesi perpunon variante te ndryshme per ta dale nga kthetret e ketyre andollakeve, te cilet kaperdisheshin per “prene” e tyre. Momenti ishte kritik, prova e veshtire. Mendja e holle e gjeti variantin me te favorshme. Pengmarresve, ne nje vend te cak-tuar qe e dintemire ajo. U thote se, kishte nevojë personale, duke

ulene ne ruajtje djepin me djalin e saj, sa te kthehej. Ajo mori pelqimin e “trimave” dhe hyri poshte rruges, ne nje vend disi te maskuar, per te mos u kthyer anadollakeve. Nderi i saj, nderi i burrit e fisit peshonin me rende se jeta e nje femije. Pikerisht pe rkete femije, i shoqi Mark Sadiku do te thoshte se “per nje djale s'e la te koritun fisin e Shales, mbas dish vjetesh!”

Zaptijet, duke ruajtur djepin, ishin te bindur se nena do te kthehej te femija i saj. Por Mirja ecte pa pushim, si nje zane, duke kaluar neper gerxhe e shkurre derisa u be e pakapshme prej tyre. Kur amuaren vesh te verteten, te turperuar, djalin e kthyen ne shtepine e tij, por nami i zi per ta u perhap me shpejtesi te madhe kudo ne malesite tona. Mustafa Efendi edhe grate e lane me gisht ne goje. Kur Veziri i Shkodres mori vesh ngjarjen, per te lare diçka nga turpi qe mbuloi pushtetin e tij, nxori nje urdher qe ndeshkonte ashper trimat e tij dhe familjet e koçakve, temos cenoheshin me.

\*Share Vatja! Duek biseduar me disa burra te fshatit Nicaj-Shale, ne nje momet doli emri i Share Vates. Ne kujtesen time ishte diçka e mjer-gullte qe ne femijerine time per kete grua, por emri i saj nuk e kisha harruar. Po kush ishte kjo grua-pyeta une?! “Nje grue me marre blea mjalte ne te”, u pergjigj njeri prej tyre. Edhe te tjeret e pohuan kete vleresim. Kjo pergjigje disi e veçante, me beri pershtypje e me shtoi kureshtjen per t'a zgjidhur biseden rreth saj. Me thane qe Shara ishte bije Lekajsh, bije e nje shtepie e permendur per nder e burreri, e martuar ne Nicaj te Shales, ne nje shtepi po aq e mire. Ajo ishte nje grue e pashme, e ndershme, e pas-

ter, e sojshme, goje embel, e njohur per karakterin dhe cilesite njerezorete saj. Keto cilesi e virtyte ia kishin rritur vleren dhe emrin e saj ne fshat edhe pse jeta e saj kishte kaluar me halle e vuajtje. Provat e veshtira, menyra se si perballohen ato tregojne karakterin e njeriun. Shara ne jete kishte kaluar disate tilla, por prova me e veshtire erdhine momentin kur ajo mori vesh se djali i saj 9 vjeçar ishte i vdekur, i therur me thike e hedhur nga shkembu ne gremine trupi i tij i njome. Po kush e beri kete hata? Nje njeri, jo normal i fisit te burrit, te cilin ajo e njihje mire, bemat e tij, torturat e vuajtjet me te nga njerez-zit e familjes. Ajo gjeti trupin e copetuar te djalit te saj. Te gjitha te trishtuan, me lot ne sy e ngushlluan Sharen “Zoti te forcofte!”-i thane. Por Shara qendronte si burrneshe, e perballoi dhimbjen e madhe, nuk shau, nuk e mallkoi autorin ekasaj ngjarje tragjike. Me trupin e copetuar ne duart e saj, rruga e çonte ne oborrin e shtepise se vrasesit. Pikerisht ketu shkelqenmadheshitia e saj logjike. Nje nga ata qe e shoqeron-te, i thote: “Share ma jep neve djalin e digji shtepine”, qe te digjej ne shtepi autori. Po, cila ishte pergjigja e Shares? “Tu thafte goja, ç'ka the? Pse, ka dale menç nje, po dalim dhe ne te tjeret? Kjo pergjigje e skuqi burrin qe ushqente hakmarrjen, “hyne fjale nga dole?!” por ishte vone. E kjo fjale e shkemoqi ate, para logjikes e qendrimit te Shares. Ngjarja e rende, teper e rende, e qendresa e kesaj sokoleshe ia rriti edhe me lart emrin e nderuar te saj para se ciles neperkulemime respekt te thelle. Ja, psebleta merrte mjalte te Shara Vatja, me thane ne mbyllje bashke me biseduesit e mi.

Nga Ndoc Grima

## Mjaltë gështënje nga Pulti

Nga inxhinier pyjesh  
Gjon Fierza, Tiranë

Tek po vizitoja “Panairin kom-bëtar të agrobiznesi Turizmi 2012,” hapur këto ditë në Tiranë, dëg-joj se dikush sqaronte vizitorët se mjalti që ai tregonte ishte mjaltë gështënje nga Pulti i Shkodrës. Unë e shpejtova ritmin e levizjes duke thirrë dhe kolegët që më shoqëronin, të arrija tek personi që tregonte këtë mjaltë. Nga larg midis njerëzve pashë Martin Lisin (Gjonin) bashkëshatarin e bashkëmoshtarin tim nga Plani. Ai që para viteve 90 ishte shperngulë nga Plani për në Velipojë. Ju afrova, më njohu midis njerëzve dhe ai, ndonse kishim gati 15 vite pa u takuar. Më thirri, pasi u përqafoam e prezantova dhe me dy kolgët e mi inxhinier pyjesh. Duke u pyetur me Martinin, na uroj mirësardhje dhe kënaqesinë që takoheshim pas shumë kohësh dhe në një mjedis të till. Martini, menjeherë na vuri përpara raki, mjaltë dhe produkte të tjera që ai dhe disa shokë ngjitur kishin sjellë në panair. U pyetëm disi gjatë me Martinin pasi kishim vite pa u takur shpejt sollem ne kujtesë dicka nga e kalura e jetes tone ne Plane, për bashkeshatarët dhe bashkëmoshtarët tane, me këto sikur u çmallem. Bisedën më tej e zhvilluam lidhur me prodhimin e mjaltit dhe mbarështimin e bletëve si një biznes që tashmë ai zhvillonte për rreth 15 vite. Kemi pasë traditë në familje mbajtjen bletëve që para viteve 90 ku kishim shumë

pak zgjoje, por sa për plotësim të nevojave shtëpiake. Tashmë kur kanë kaluar 15 vite, Martini kishte krijuar një park me rreth 150 dhe kishte si objektivi të arrinte deri 200 zgjoje. Eshtë një veprimtari e veshtirë, do pasion e përkushtim por dhe njohuri të mira teknike. Kerkohet të njohesh tregun dhe të bashkepunosh dhe me kolegët. Mbi të gjitha kerkohet mjaltë pa hile dhe unë të till e prodhoj.

Mjalti tërësisht natyral me lulet nga bjeshkët e Planit, nga gështenjat e Pultit është i një cilësie tepër të mirë. Martini jua prezanton vizitorëve “Mjaltë gështënje nga Pulti” dikush do dhe disa sqarime më shumë për këtë zonë, jo shumë e njohur për këtë produkt. Martini tashmë si një mbrështues profesionist i bleteve thotë se: I shtegtoj bletët nga Velipoja, në disa fshata në Mirditë, etj, por në periudhën kryesore të grumbullimit të mjaltit ato I shtegtoj në Plan. Fshati Plan, porthuajse e gjithë zona e Pultit në tërësi është ndër zonat më të mira për zhvillim të bletarisë. Ka një bollshmeri dhe shumilleshmeri lulesh ku bletet mbushen me shumë ngarkesë. Në Pult, nga maji deri në shtator shtegtohen me mijra zgjoje bletesh nga shumë mbarështues të tyre nga zona të ndryshme të Shkodrës dhe më tej. Sigurisht për

Martinin ka rëndësi, këtë ai po përpiqet të promovojë më së miri mjaltin gështënjes nga Pulti. Tashmë mjalti duket se ka një treg të mirë në veçanti ai gështënjes kerkohet për cilesitë e tij të veçanta kuruese. Biseda vazhdoi disi gjatë, ku dhe kolegët e mi tashmë po I bënin mjaft pyetje dhe vendosen kontaktet me Martinin. Nderkohë, herë pas here Martini komunikonte me vizitorët, ju bënte sqarime e nevojshme dhe shumë prej tyre jo vetëm e provonin mjaltin por dhe blinin atë. Martini tha se: konsumatorët tashmë



janë shumë të ndjeshëm ndaj cilesisë, dhe kjo për mua dhe koleget e mi, është kryesore. Me mjaltin, disa vite ka pasë shumë spekulime e fallsifikime në treg, diku ato vazhdojnë dhe sot. Konsumatorët nuk blenin mjaltin se nuk arrinin të përcaktonin në se ajo ishte natyrore apo prodhim sheqeri!. Tashmë konsumatorët janë më të mirinformuar, bile duan të njohin dhe ty si prodhues apo tregtar që mallin e blerë ta kenë të garantur.

Martini tha se nga qeveria na është premtur mbeshtetje neper-

mjet donacioneve të zhvillimit rural, për ne që mbreshtojmë parqe të mëdha bletësh, kemi plotësuar dhe dokumentat e kerkura, por për fatkeq deri tani kur kanë kaluar dy vite nuk kemi përfituar asnjë lek. Zv Ministri Ministrise Bujqesisë në bisedë me ne këtu në panair, na tha se ky problem do verifikohet dhe do marrë zgjidhje për të marrë vlerën që ju takon sipas vendimeve të Qeverisë. Kjo mbështetje do i shërbejë akoma më mirë zhvillimit bletarisë në gjith qarkun e Shkodrës. Tashme ky qark nga viti në vit po bëhet ndër prodhuesit kryesor të mjaltës cilesore të gështenjës dhe sherbelës. Martin Lisi (Gjoni) thotë se: kete veprimtari e kam pasion dhe vazhdim të traditës familjare. Unë kam pasaportë amerikane shton ai, në periudha të shkurtëra shkoj në SHBA, por mjendjen e kam tek bletet këtu në Shqipëri, prandaj nuk qëndroj gjatë atje. Marrja me bletë, shtegtimi I përvitshëm në Plan më ka berë që me vendlindjen të jem i lidhur persëri. Më vjen keq, ndjeh disi i mërztur kur jam në Plan, pasi pak familje jetojnë sot atje. Ka familje që jetojnë në Shkodër dhe verojnë atje, ky numer duket se po vjen duke u rritë kjo eshte positive.

Pulti, është një zonë fitoklimatike shumë e favorshme ku zhvillohet mirë gështënja, arra, lajthia, etj. Në këtë zonë, është prodhuar raki e mirë: rrushu, kumbulle, mani dhe veçanarisht raki thane, sot mjaft

e kërkuar nga tregu. Vena (vera) e rrushit me erë (çylek) që kultivohet tradicionalisht në këtë zonë është nder të veçantat dhe tërësisht si porodukt Bio. Grosha Shalës (fasulja), për dekda ka qënë ndër produktet bujqesore me të kërkua në tregun e Shkodrës, përsëri mund të jetë një produkt që gjenë treg të mirë. Janë këto produkte dhe të tjera të cilat janë prodhuar dhe sot janë mundesitë që të prodhohen në Pult. Eshtë Luginë e Kirit me peizazhin, me monumentet e sajë natyrore për fat keq, deri tani pak e njohur që së shpejti do të jetë një shtegtim i ri turistik. Turistet që vijnë në Theth, kthimin për në Shkodër do e bëjnë duke kaluar në luginën e Shalës në Shosh dhe pastaj luginen e Kirit. Pra ashtu si Thethi sot, dhe zonat e tjera të Dukagjinit kanë një të ardhme të mirë turistike. Kerkohet që tashmë dhe për këto intenerare të reja turistike të punohet akoma më shumë së për ti njohur dhe promovuar sa më shpejt.

Le të shpresojmë se në panairin e ardhshëm të jenë më shumë kolegë e bashkëshatrë të Martinit, prodhues të tjerë, guida të reja turistike për zonat e tjera të Dukagjinit. Kjo do i shërbejë së pari dukagjinase për të vlerësuar pasuritë e tyre dhe jo vetem për vete por dhe në shërbim të zhvillimit e përparimit të Dukagjinit në tërësi.

Shqipëria, është vënd i vogël, ne kemi pak tokë, asnjë skaj i sajë nuk duhet braktisur. Çdo pellëmbë e kësaj toke ka vlera të medha sot, por shumë më shumë do ketë në të ardhmen, le tua trashgojmë brezave që vijnë për begatinë e tyre.

# KUJTIME NGA PUNA IME NË DUKAGJIN



Nga Isa Alibali

Duke diskutuar për problemet që lidhen me temën shumë aktuale "Integrimi – çeshtje botëkuptimi" botuar para shume kohësh edhe në gazetën "DUKAGJINI" të autorit Luigj Shyti, mendo-va t'i dergoj kësaj gazete disa mendime nga ana ime. Problemet që shtrihen në këtë artikull interesant, në përgjithësi janë pjesë e rëndësishme të jetës sonë të përditëshme, të bisedave mes njerëve të kategorive të ndryshme shoqërore, do të thosha deri edhe në çdo familje. Ndonëse kjo është një temë që kërkon një zbrithim më të plotë dhe të gjithanshëm, më të hapur dhe gjithëpërfshirës. Gjithsesi, në gazetën tuaj shprehen konceptet e drejta për këtë temë të rëndësishme, duke theksuar se integrimi është çeshtje botëkuptimi dhe se kjo gjë i takon të dy palëve: si qytetarëve "të rinj" ashtu edhe qytetarëve "të vjetër".

Për të ndihmuar sado pak në një trajtim disi ndryshe të problemit, po sjell dy ngjarje nga puna ime në Dukagjin.

Në vitet 1961-1965, për katër vjet me rradhë, kam qenë inspektor në seksionin e arsimit e të kulturës në Shkodër dhe kisha në vartësi direkte zonën e Dukagjinit. Kjo detyrë më ka bërë të shkoj atje shumë e shumë herë, për të ndihmuar dhe kontrolluar në mbarëvajtjen e shkollave të kësaj zone të thellë malore.

Besoj se duke treguar vetëm dy nga ngjarjet e shumta që më kanë mbetur në kujtesë dhe më kanë lënë mbresa të thella dhe të pashlyera, do të shpreh vlerësimin tim për jetën dhe njerëzit në Dukagjin.

## Ngjarja e parë:

Ishte viti 1962. Mbasi mbarova punë në shkollën fillore të fshatit Ndrejaj në zonën e Shoshit, ku ishin mësues Arti Kurbin me të shoqen, Luçije, po bisedonim me Artin përpara shkollës, kur shohim duke ecur një burrë, që mbante në shpinë një raft. Ai ecte me hapa të ngadaltë, gjithnjë me të njëjtin ritëm.

- E sheh atë, - më tha Arti, - që nga Bregu i Lumit ecën kështu, me raft mbi supe.

Unë mbeta.

- Si është e mundur!? - i thashë menjëherë mësuesit të shkollës, i çuditur, por edhe duke shprehur mosbesim. Vërtetë nuk kishte rrugë makine, por si ishte e mundur një gjë e tillë?!

- Po, dje, kur shkoj në Breg të Lumit, u ndal pak këtu e ma tha vetë.

E njihja mirë atë rrugë këmbësore. Sa e sa herë i isha ngjitur dhe ulur të përjetave dhe të tatpjetave të saj me mundimet që të krijonte ajo, dhe e kuptoja mirë vështirësinë që po kalonte burri që kishim përpara, me raftin mbi supe.

- A e di ku e ka shtëpinë? - pyeti Arti dhe menjëherë vazhdoi: - Ja, e shikon atë shtëpinë atje larg - dhe bëri me dorë andej nga shtëpia e atij burrit. - A e sheh si duket mali aty? Ajo lagje quhet Bulli i Palajve. Aty e ka shtëpinë.

U shtanga. I duhej të kalonte një rrugë përsëri të gjatë, me ulje e zbritje të theksuara deri sa të arrinte në shtëpi.

- Kush e di sa orë do të bëjë ai për të arritur?! - e pyeta i çuditur.

- Nga qendra, Bregu i Lumit, deri në shtëpinë e tij, bëjnë tri orë e gjysmë po të ecet normalisht. Llogarite vetë se sa kohë duhet ...

Kjo ngjarje e thjeshtë në dukje, më futi në mendime. Çfarë force fizike kishte në vete ky njeri, që në ato momente m'u duk i jashtëzakonshëm?

Në mendje më shkoi Atllasi, siç e përfytyronim nga mitologjia që kishim mësuar. Po, me të vërtetë më dukej si një vigan, tek e shija me raftin mbi supet. Sikur po mbante botën ...

Megjithë këmbënguljen dashamirëse të Artit për të kaluar atë natë në Ndrejaj, vendosa të nisesha për në Palaj, për të qenë aty të nesërmen në mëngjes, kur të fillonte mësimi.

Pas rreth 50 minutash rrugë, arrita në shkollën 7-veçare Palaj, ku gjeta mësuesin Avni Kastrati.

- Mirë se erdhe, - më tha me fytyrë të çelur.

Njiheshim prej kohësh. Kishte dëshirë që atë natë ta kalonim mirë. Gjithsesi ndenjëm rreth një orë e gjysmë bashkë, duke biseduar për të rejtat e qytetit që ai nuk i kishte marrë vesh, sepse kishte rreth dy muaj që nuk kishte lëvizur nga shkolla.

- Do të shkojmë te një shtëpi, ku do të kënaqemi, a je dakort? - kërkoi që të merrte mendimin tim. - Apo je i lodhur e ke nevojë të pushosh këtu, me këto kushte që kemi?

- Si të duash, - i thashë, - ti je zot shtëpie dhe vendos vetë. Nuk jam i lodhur.

U nisëm menjëherë. Rrugës më tha se do të shkojmë në shtëpinë e Kolë Delisë. Kur arritëm në shtëpinë e caktuar, dy gra të shtëpisë na pritën shumë ngrohtë.

- A është Kola në shtëpi?! - i pyeti Avniu ato.

- Po, - thanë të dyja përnjëherësh. Urdhëroni brënda, - na ftuan me përzemësi.

U futëm në një dhomë të pastër e të rregullt. U ulëm pranë oxhakut. Pasi kaluan rreth 20 minuta, u duk një burrë i gjatë, i veshur pastër e bukur. Dukej që sapo kishte bërë banjë. Na shprehu mirëseardhjen me një ngrohtësi që të bënte përshtypje. Nga lëvizjet që bënte dhe mënyra se si fliste, duke lëvizur duart me shkathtësi, dukej një njeri energjik.

Kur u shtuam në të pirë e në të ngrënë, vura re se ishte edhe me humor. Bisedën e bënte të shtuar, të ngrohtë e të çelur. Nuk ishte e vështirë t'i dalloje në fytyrë kënaqësinë që ishim mysafirë të tij atë natë. Përzemërsia me të cilën na priti dhe biseda e këndshme dhe e gjallë e tij na ngrohu shumë. Nuk vumë re tek ai njeri asnjë shenjë lodhjeje. Përkundrazi, ishte plot energji. Kaluam një natë shumë të këndshme, deri mbas mesnate ...

Të nesërmen, krejt rastësisht, morëm vesh se ai burri, që kishte mbajtur mbi supe gjithë ditën e ditës atë raft, ishte pikrisht mikpritësi ynë, Kolë Delija. Në mendjen time, figura e tij mori përmasa të tjera, të reja, të paimagjueshme, fisnike, madhështore. Kishte në qëndrimin e tij jo vetëm forcë, qëndresë e burrëri, por veçanërisht mikpritje, bujari e mbi të gjitha fisnikri.

Me dhjetra herë mund ta kem treguar këtë ngjarje, sa herë që binte fjala për të shprehur vetitë fizike dhe morale të malësorëve tanë.

Kolë Delia, ai burrë fisnik nga fshati Palaj i Shoshit, ka vite që nuk jeton. Por më kanë thënë se djali i tij ndodhet në Shkodër. Shpresoj ta takoj ...

## Ngjarja e dytë:

Si inspektor i zonës, ishte ngritur një grup pune për të ndihmuar në fillimin e vitit të ri shkollor të sistemit veror që fil-

lonte me 1 mars. Ishte viti 1963.

Ne ishim pesë vetë: Zef Tafili, Ramadan Garuci, Gjergj Progni, Selaudin Kopliku dhe unë. Deri te Ura e Shtrenjtë shkuam me makinë. Pastaj, deri në Prekal e në vazhdim në këmbë. U ndalëm pak te uji i ftohtë i Proit të Zhyllës. Aty ishin edhe disa malësor që do të bënin rrugën për në fshatin e tyre. U bashkuam me ta dhe ndjemë kënaqësinë e bisedës së tyre të këndshme, për të na e bërë rrugën sa më të lehtë. Kur duhej të ndaheshim, sepse ata do të shkonin për në fshatin Kir, na dhanë udhëzimet e duhura se nga do të kalonim:

- E shihni atë qafën atje, - dhe drejtuan gishtin nga një shteg i mbuluar me dëborë. - Ndiqni vetëm rrugën e shkelur prej të tjerëve dhe nuk do ta keni të vështirë, - na dhanë zemër.

U ndamë prej tyre me besimin se çdo gjë do të na shkonte mirë.

Kisha qenë disa herë në Palaj Shosh, por asnjëherë nga kjo rrugë. As të tjerët nuk kishin kaluar këtej. Madje, tre prej shokëve të mi nuk kishin qenë asnjëherë në Dukagjin.

Duke biseduar, duke qeshur e ndonjëherë edhe duke kënduar, vazhduam rrugën, entuziazatë dhe të kënaqur që po na ecte mbarë.

Por papritmas na ndodhi një gjë që s'e kishim menduar. Ramadan kishte mbetur pak mbrapa dhe në fillim nuk e vumë re një gjë të tillë.

- Pushoni pak këtu, Ramadan është ndalur diku, - u thashë.

U ktheva pak dhe e pashë duke pushuar. Fytyra ishte zbehur dhe i ishte mbuluar me bula djerse. Buzët i kishte të nxira. I dridhej tërë trupi.

- Ramadan, ti nuk je mirë, - i thashë pa u menduar më shumë. U shqetësova.

- S'e di ç'kam. Më erdhi papritmas një debulesë.

U ula pranë tij.

- Si thua, të kthehem? - i thashë menjëherë.

- Në asnjë mënyrë, do të më kalojë, do të eci vetë.

U ngrit menjëherë, por zbehtësia e fytyrës nuk iu largua. E kapa për krahu dhe shkuam deri të shokët. Edhe ata u tronditën. Nuk dinim çfarë të bënim. Të vazhdonim me shokun të sëmurë, ishte e vështirë. Të ktheheshim edhe më e vështirë, sepse ishim larguar shumë. Nuk kishim afër ndonjë fshat apo ndonjë shtëpi, që të paktën të kujdeseshim për Ramadanin. Ç'të bënim?!

- Të vazhdojmë rrugën, - tha Ramadan kur vuri re dilemën tonë. Nuk donte që të bëhej shkaktar për kthimin tonë.

- Të paktën të kishim ndonjë aspirinë? - tha Selaudini.

- Kam unë, - tha Zefi, më i moshuari mes nesh. Ramadan e piu menjëherë. Gjergji e kapi për krahu dhe ne vazhduam ecjen. Sigurisht me hapa më të ngadaltë. Kështu njëfarë kohe, duke e mbajtur herë njëri e herë tjetri. Pastaj u detyruam që Ramadanin ta mbanim dy vetë.

Vështirësitë po na shtoheshin, së bashku me errësirën që nuk vonoi të mbulon- te çdo gjë. U futëm në zonën e dëborës. Bardhësia e saj na ndihmonte të shihnim nga hidhnm hapat. Asnjë gjurmë se kishte kaluar ndonjë njeri andej, sepse dëborë e re i kishte mbuluar ato. Dinim vetëm se duhet të ngjiteshim, vetëm të ngjiteshim.

Për fatin e të gjithëve, Ramadan filloi të bëhej më mirë. Por ishim shumë të lodhur, të gjithë. Ai më shumë se ne të tjerët. Me forcë e vullnet, filloi të mos ketë nevojë për ndihmën tonë.

- Tashti që e arritëm Qafën e Shoshit, të ndalemi e të ndezim një zjarr, të pushojmë pak e ndoshta ta kalojmë natën

rrreth një zjarri që duhet të ndezim, - tha njeri prej shokëve.

- Në asnjë mënyrë, - fola prerë. Ndosh-ta edhe e ngrita pak zërin, që të bëja më shumë efekt. Kisha dëgjuar se, po të ndezësh zjarr në dëborë e të rrisht pranë tij për një kohë, mund të vdesësh. Ua shpjegova.

U detyruam të vazhdonim udhëtimin, rrugë e pa rrugë. Nga të na shkelnin këmbët.

- Edhe sa kohë do të ecim?! - pyeti Gjergji.

- Mos pyet për kohë, ne do të arrijmë, - u përpoqa t'u jap kurrajë, edhe pse e ndiejsha tronditjen.

- Të ecim gjithnjë mes pemëve, se mos biem në ndonjë humnerë, - tha Zefi, kur dëborë filloi të bëhej më e rrallë dhe nuk shihnim si më parë. Ashtu bëmë.

Tashti e kishim më të lehtë, sepse edhe Ramadanit i kaloi ajo gjendje e rënduar dhe ne vetëm zbrisnim, me njëfarë ndjenje gëzimi se do të arrinim shpejt pranë ndonjë shtëpie.

Ec e ec dhe ora kaloi dhjetë e natës. Filloi shqetësimi. Por, papritmas pamë një siluet drite. Filluam të thërrisnim emra të ndryshëm, pa ditur se pranë cilës shtëpi jemi.

Iu afruam shtëpisë ku pamë pak dritë dhe vumë re se dikush doli me një ndriçues në dorë.

Kur u futëm në shtëpi, pamë rreth tridhjetë burra në këmbë. Ne ishim të lodhur, të rraskapitur, të lagur deri në palcë.

Ishin të habitur me ne, nga që u futem kaq vonë në një shtëpi të panjohur. Pashë mes tyre një burrë që unë e njihja. Ishte kryetari i këshillit të fshatit:

- Ku je, Tomë Luca, - i thashë duke buzëqeshur. Edhe ai më njihte. Kaq duhej për t'u shkrirë "akulli" mes nesh.

Ndërkohë, i zoti i shtëpisë, Lekë Nika na u afrua menjëherë dhe na ftoi të futeshim në dhomë. Të tjerët filluan të largoheshin duke na dhënë përshëndetur ngrohtësisht. Ata lanë përgjysmë një festë fetare në shtëpinë e Lekë Nikës dhe u shpërndanë në shtëpitë e tyre. Qëndroi vetëm Stak Ndoja nga Kiri. (Disa ditë më vonë shkuam edhe në shtëpinë e tij, ku gjetëm një mikpritje po aq të veçantë).

Ndërsa ne na u krijuan kushte aq të mira, pas asaj gjendjeje plot lodhje dhe ankth, sa që e ndiemë veten pothuese si në shtëpitë tona. Menjëherë na sollën rroba për t'u ndërruar, na sollën ujë të ngrohtë për këmbët tona të ftohta dhe të lodhura dhe na vunë rreth oxhakut, ku buburiste zjarri që u rindes menjëherë. Në krye të të gjithë këtij kujdesi qëndronte Lekë Nika, një burrë në moshë, por gjithë gjallëri dhe preokupacion për të na ardhë rreth sa më mirë. Në fytyrën e tij shihej edhe shqetësim, edhe kënaqësi. Shqetësim për gjendjen në të cilën u futëm në shtëpinë e tij dhe kënaqësi se po na krijonte një gjendje të rehatshme dhe të gëzueshme...

Të nesërmen ishim krejtësisht të çlodhur. Në tërë fshatin Palaj u hap lajmi se ekipi i arsimtarëve kishte kaluar natën vonë në buzë të humnerës. Rreth nesh u mblodhën shumë pleq e të rinj, si dhe nxënës të shkollës:

- Ja nga kanë kaluar. Edhe ne të kishim qenë, do të kishim rënë në humnerë, - i thonin njeri tjetrit.

Ne e ndienim veten krenarë, jo pse kishim shpëtuar nga e keqja, por se kishim dalë fitues mbi të. Por mbi të gjitha ishim të gëzuar se gjetëm në këtë fshat njerëz të mirë, të dashur dhe mikpritës.

Asnjëherë nuk e kam harruar plakun e urtë e të mirë Lekë Nika, nga Palajt e Shoshit.

# SFIDAT EKZISTENCIALE TË INTEGRIMI

“LOKOMOTIVA” E UNIONIT KA DEFEKTE NË INGRANAZHET E MOTORIT



Nga Luigi Temali

“Krizat e vërtetë në Evropë nuk është e natyrës ekonomike dhe as financiare. Ajo ka më tepër arsye të thella sociale dhe politike”. Të ndodhur para kësaj situatë të rrezikshme disa personalitete të shquara evropiane kërkohjnë reformimin e mëtejshëm dhe të plotë të strukturave politike drejtuese të Bashkimit Evropian. Për ta ndryshuar këtë duhet të bashkohet posti i Kryetarit të Komisionit të BE dhe i Presidentit të Parlamentit Evropian. Propozimi i Sikorskit është një hap përpara drejt Unionit në bazë të marrëveshjes së Maastrichtit të vitit 1992.

Krizat e borxheve ka tronditur në mënyrë të frikshme themelet mbi të cilat është ngritur “Ndërtesa” gjigande e BE. Kjo krizë, së pari, është rezultante e “Vrimave të zeza” të krijuara në menaxhimin jo profesional e të përkushtuar të mjeteve financiare në përdorim, të cilat shpesh herë qëndrojnë jashtë pamjes e vëmendjes së opinionit publik.

Krizat e borxheve, “Thembra Evropiane e Akilit”, ka disa nënshtresa, si ato teknike nëntokësore, përpjesa e të cilave do të shkaktojë tërmete edhe me të fuqishme me pasojë katastrofike. Solidariteti për bashkimin e mëtejshëm të Evropës ka humbur mjaft forcë prej borxheve të mëdha. Në një situatë kolapsi të pazakontë, pa mjete financiare, rrugë dalje dhe me arka bosh ndodhet fqinji ynë jugor Greqia. Ajo, për vite me radhë ka mbyllur sytë duke shkuar si pa “vetëdije” dhe me këmbët e saj drejt greminës. E Diele, 17 Qershor 2012, ishte dita e votimeve. Shpresojmë të fitojë demokracia...! Greqia, Shqipëria dhe i gjithë Ballkani i takojnë Evropës. Atje gjenden “Thesaret” më të çmuara të kontinentit! Pa ato s’ka Union Evropian.

Diferencimet e mëdha pasurore të vendeve veri-jug dhe lindje-perëndim të kontinentit janë tregues kuptimplotë të zhvillimit të pabarabart të Kapitalizmit. ... Në kushtet e Kapitalizmit Shtetet e Bashkuara të Evropës ose janë të pamundura, ose janë reaksionare. Pabarazia e zhvillimit ekonomik dhe politik është një ligj absolut i Kapitalizmit. Miliarderi nuk mund t’i ndajë me ndonjë tjetër të ardhurat kombëtare të vendit kapitalist, veçse në bazë të një përpjesëtimi të caktuar sipas kapitalit, bile me ndonjë shtesë në mënyrë që kapitali i madh të marrë më shumë nga sa i takon”. Lenin Vepra të zgjedhura Vëllimi i parë Social – Demokraci, Nr 44, 23 Gusht 1915

“Mjerisht kriza vazhdon! Ajo prek themelet e sistemit. Pa diagnostikimin e sëmundjes s’ka shërim të organizmit. Bota në rrugën e gjatë e të vështirë drejt Globalizmit do të përballë me situatë edhe më dramatike, të cilat nëse nuk “operohen” shpejt dhe me të gjitha “bisturitë e nevojshme kirurgjikale” do të sjellin tragjikisht “Tërmetet” të tjera me efekte shkatërruese të pallagaritshme.

“Ndërhyrjet e qeverive...! Askush nuk është “Kërthiza e Botës”! As Perëndimi! Balanca po anon nga Lindja, djepi i kulturave, qytetërimeve dhe i religjioneve. Burimet financiare të një shteti, edhe më i pasuri i planetit, kanë një kufi...Pas tij vjen rrënim...! Nevojiten ura të reja komunikimi dhe bashkëpunimi”. L. T. Gazeta “Ndryshe” - Globalizmi E Mërkurë, 22 Prill 2009.

Në ujërat e ftohta të oqeanit Atlantik dukën me vështirësi majat e ajsgjergëve. Degradimi i vlerave i merr hap pas hapi “oksigjenin” vendeve të BE. Politika po mbytet ekonominë! Disa klane qeverisëse të paskrupuj, për të mbajtur me çdo kusht e çmim pushtetin, sidomos në fushat elektorale që s’kanë mbarim, harxhojnë qindra miliona euro para publike, shpesh herë jashtë mundësive që kushtëzojnë Prodhimi i Përgjithshëm Bruto dhe Buxheti i shtetit. duke shkelur me të dyja këmbët, me shpërfillje e megalomani ligjet ekonomike objektive të Kapitalizmit.

“Fshati që duket nuk do kallauz”. Me shqetësim shohim, të zhytur thellë në “moçalin” e borxheve të mëdha, edhe Spanjën krenare të kalorësisë mesjetare, e luftërave heroike për liri e demokraci si edhe e këngëve, valëve dhe serenatave pa fund. Ingranazhet e motorëve të këtij shteti të madh evropian kanë filluar të ndryshkohen. Ajo ka mbetur në udhëkryq! “Qeveria Spanjolle ka shpenzuar tashmë 15 miliard euro duke ndihmuar banka të vogla rajonale kurrsimi që huazonin në mënyrë të pamatur para zhvilluesve të pronave”. Kalbëzimi i sistemeve bankare është një indikator sinjalizues për kohë më të vështira...“ Zyra e Statistikave të BE Eurostat parashikon se BE, në vitin 2050, duke marrë si konstante fikse gjendjen e popullsisë të sotme, do të jetojnë 48 milion njerëz më pak në moshë të aftë për punë dhe do të ketë 58 milion më shumë njerëz mbi 65 vjeç. Nëse bie popullata në moshë të aftë për punë, bie zhvillimi ekonomik. Financimi i sistemeve të sigurimeve sociale, pensione dhe sigurimeve shoqërore do të ishte në rrezik”.

Për shërimin e kësaj sëmundjeje të rëndë kanceroze Aleksandër Graf Lamsdorff, një pragmatist i shquar, këshillon që si pasojë e ndryshimeve demografike në BE duhet të forcohet gara për fuqi të kualifikuar pune. “Sfida më e madhe do ishte që emigrimi të bëhet në atë mënyrë që të ishte produktiv për shoqërinë”. Emigracioni, “Çelësi i Artë” i të ardhmes së ndritur evropiane! Paradoksale! E thënë ndryshe “Miopi Politike”, e cila ka zënë rrënjë të thella në subkoshiençen e disa personaliteteve të Unionit. Plakët çdo ditë popullsisë dhe ulet me miliona në vit numri i personave të aftë për punë megjithatë, ky fenomen tej mase i rrezikshëm për shoqëritë njerëzore, konsiderohet një diçka e “natyrishtme”, e riparueshme dhe normale!

Mjerisht Mister Pan Kapitali i markës “Made In Smith” ndodhet në fazën e fundit të ekzistencës...! Integrimi rajonal, kontinental dhe global kërkohet një botë vizionare e të drejtë si edhe alternativa, ide, parime e norma morale të konsoliduara. Zotërinj, amnezia

e juaj është e rrezikshme! Familja evropiane është tronditur rëndë! Lindjet e pakta, martesat me kontratë dhe brenda llojit, divorcet, familjet në shpërbërje, abortet gjithandej, jeta e shthurur pa sens, droga, prostitucioni, inkurajimi i antivlerave, varfërimi i botës shpirtërore, materializmi i egër, gara për të “shijuar” pa limit, me hire e me pahir të gjitha të “Mirat e Jetës”, krahas plagëve ende të pashëruara të shoqërive të sotme, po e çojnë Evropën, kontinentin plak, drejtë një “Apokalipsi” social, demografik dhe ekonomik me pasojë shkatërrimtare të paimaginueshme.

Evropianët, ndryshe nga baballarët, gjyshërit e stërgjyshërit e tyre, nuk i kushtojnë kohën, mundin dhe kujdesin aq sa duhet gjeneratave të reja. Gjithashtu, jo pakkush nga ata, janë mbërthyer nga parazitizmi, dembelizmi dhe megalomania. Si padronët mesjetar, meqenëse kanë pasuri dhe para, kërkohet nga skamnorët deri tek shërbimet ekstra, sepse varfëria, regjimet antipopullore dhe “Flakët e Ferrit” i kanë detyruar të trokasin në portat e tyre.

Sfida e borxheve, prova më e madhe e mbijetesës së popujve evropian pas dy luftërave botërore të shekullit të 20-të. E ardhmja në duart e Angela Merkel: “Edhe forca e Gjermanisë nuk është e pafundme. Fuqitë tona nuk janë të pashtershme. Evropa duhet të përqendrohet tek integrimi politik, sado e vështirë të jetë kjo detyrë”. Në unison me Kancelaren Gjermane Barroso paralajmëron stuhi të fuqishme politike: “Vendet anëtare të BE-së duhet të heqin dorë nga sovraniteti kombëtar në luftë kundër krizës ekonomike. Bashkimi Evropian gjendet në fazën vendimtare për tejkalimin e krizës”.

Modeli më premtues përvoja e grumbulluar. Parlamenti dhe Komisioni Evropian nuk disponojnë plotësisht autoritetin, kompetencat, mjetet e burimet e nevojshme politike, ekonomiko-financiare e ushtarake për zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të Unionit. Nevojitet një superstrukturë e re politike, e krijuar sipas imazhit të një super shteti, ndoshta “Made In USA” Financat, “Leva e Arkimedidit”, sundimtari absolutet i të gjithë kohëve. Kjo kërkohet heqje dorë nga sovraniteti! Dilema dhe privacione! S’ka lindje pa dhimbje! Mbijetesa e Njerëzimit në udhëkryqet e Përparimit!

## POETIT DHE PUBLICISTIT MARASH MEHILLI

-Peng nderimit -

Nji “Kupe e sjell” me ujë të “krypun”  
E çova “Eks” me shumë kënaqësi,  
Me dergonte miku i im mendje ndritun  
Nga Akropoli i asht i shtetit fqinje.

Me durimin e hekur të Penelopes  
Me forcen e pendes gjith mitet i theu  
Forcën, miku im e mori prej tokës  
Ashtu siç e merrte i lashti Anteu.

Vargjet dhe proza si gjerdan prej arit  
Shkëlqim rrezatojnë si burimi i bjeshkës  
Ky asht potreti i vertete i shkrimtarit  
Që flet gjithnji me gjuhen e së vertetes.

Soditi Akropolin dhe brigjet e Egjeut  
Me syrin e mendjes dhe shpirtin e poetit  
Por, Ai donte flladin e bjeshkeve t’Atdheut  
Fushat me lule dhe kaltersine e detit.

Sa shumë miku im ngjason me Naimin,  
me Fishten, Çajupin e Gurakuqin e madh  
Se joshi lakmia asnjëhere trimin  
Burrin e mençur me ideal.

Shënim: Në vargje dhe në proze, Marashi na rrefeu se ska gja ma të dashtun se sa Atdheun. Shkrimtari Marash Mehilli asht autor i gjashte librave me plote vlere. “Nje kupe Egjeu”, asht libri i gjashte.

Duke qene se kam punue me te, në nji hark kohor prej 8 vitesh, e njoh nga afër, dhe mund të konfirmoj me bindje të plote se asht nder percjellesit e radhe të fjales artistike në nivel vendi. Jam marre mbi 35 vjet me “levizjen amatore” dhe radhe me ka qellue me pa ndonji recitues apo prezantues me kapacitetin e tij. Marashin e kane vleresue artistet e klasit të nalte, si Ndreka Luca, Lec Bushati, Dritero Agolli dhe Ismail Kadare, në Fierze, por edhe në Lidhjen e Shkrimtareve, ne vitin 1975.

Nga Mark Bregu

## KURIOZITETE

Për të hequr njollat e ndryshkut nga një copë e bardhë ose e ngjyrosur (por që nuk i del boja), duhet që vendi i njollosur të mbulohet me kripë e limon (e përzier më parë bashkë), duke e lënë për disa orë kështu, pastaj shpërlahet me ujë të ftohtë e hekuroset me hekur mjaft të nxehtë.

-o-

Kur gatvani gjellë me karota ose bizele, që të bëhen më të shijshme u hidhni një maje thike sheqer.

-o-

Thika është 100 000 vjete më e vjetër se piruni. Ky i fundit filloi të përdoret vetëm rreth 300 vjet më parë.

-o-

Syri i njeriut peshon 4000 herë më pak se gjithë trupi.

-o-

Nga djegia e plotë e një gram urani çlirohen 200 bilion kalori nxehtësi, një sasi e tillë nxehtësie mund të fitohet nga djegia e 1700 T. Benzinë, ose 1500 T. Qymyr guri.

-o-

Që të fitohet 1 gram radium duhet të përpunohet 500 T Mineral, të harxhohen 500 T reaktiv, 1000 T qymyr guri, 10000 T ujë dhe të punojnë për një muaj rresht 100 punëtor dhe kimistë.

-o-

Për numërimin e molekulave që gjenden në 1 gram ujë duhen 3 milion vjet qe se do të merren me këtë punë një milion njerëz duke numëruar për çdo sekondë një molekulë.

-----

I mbloodhi Luigi Shyti



# TURIZEM I SUKSESSHEM NE SHENGJIN

Shume persona kushtezohen në menyre të pavetedishme të mendojnë negativisht dhe mendimi pozitiv behet utopi e paster ose madje shenje e ndergjegjes, duke ngaterruar të qenurit pesimist me ate realist. Realiteti eshte ai që pasqyron punen dhe veprimtarine e secilit individ e të shoqërise në tërësi. Në ambientet ku banojme apo punojme e pushojme, degjon mendime nga me te ndryshmet. Kuptohet pro e kundra, por kur shumica kane rene ne pesimizem, atehere jemi te detyruar te analizojme shkaqet.

Po ti referohemi vitit 2010, ne Komunen e Shengjinit shumica e pushuesve kishin rene ne pesimizem, duke arsyetuar se nuk shkohet ne plazh nga pa pastertite e mungesa e infrastruktures. Ndertimet pa leje mbinin si kerpuhat ngjitur me ujin e detit. Plehrat e papastertite te zinin frymen e nuk behesh fjale per plazhet publike. Lopet, derrat e qenet rrugac ishin banor te perhershëm te plazhit. Ujrat e zeza dhe ato te perpunimit te peshkut derdeshin ne det. Keto i benin njerzit pesimist. Por optimizmin ta rrite puna e drejtuesve te afte qe ndryshojne situaten për mire. Ndonëse për një vit situata ne Komunen e Shengjinit eshte krejt tjetër, mbase nuk eshte teper te themi si nata me ditën. Me fitoren bindshem ne zgjedhjet e kaluara te Kryetarit te Komunese Shengjin, Salvador Kaçaj, u arrite qe te behen ndryshime te dukshme.

Punen e filloje duke restuaruar tersishte godinen e komunese, e cila ishte lene ne meshire te fatit sa edhe oborri ja kishin zaptuar hotelet per rreth. Rregulloje shetitoren duke hequr shtyllat telefonike e elektrike te cilat te kujtononin qytetet e viteve 1930.

Pastroje plazhin nga qendrat e zjarrit, te cilat kishin mbetur si relike zije, u prishen ndertimet pa leje, zgjidhi njehere e mire

mbajtjen paster te qytetit e te plazhit, duke vendosur tualete e kosha per hedhjen e mbeturinave. Nje kerkese e komunitetit ishte percaktimi i plazheve publike, te cilat ishin mohuar e kjo u arrit menjehere.

Sigurimi i rendit e qetesise me anagazhimin e policise komunare, e cila funksionon me tre turne. Ashtu si funksionon edhe ndermarrja e pastrim gjelbrimit, kerkesa e llogarise ka bere qe ne te gjithë plazhin nuk te kape syri ndonje papasterti, kjo ka ndikuar edhe tek pushuesit



per te mbajtur paster ambientin ku pushojne. Masat e marra e permiresimi i kushteve te pushimit, sherbimi i shkelqyer i hotelerise e akomodimit, kane bere qe numri pushuesve ne plazhin e shengjinit te trefishohet ne krahasim me vitin 2010.

Arritje ka ne gjithë teritorin administra-

tive te kesaj komune. Investime te shumta jane bere ne Ishull Lezhe, Ishull Shengjin, pa bere fjale se me kryesoret behen ne qytetin e Shengjinit deri te ura e Merxhanit. Menjehere pas perfundimit te plazhit do fillojne edhe investimet siç eshte rruga Shengjin-Kune, shetitorja ne qytet dhe ne plazhe investime keto qe kapin shumen e mijllardeve leke. Investime te rendsishme jane bere edhe ne fshatrat e kesaj komune si ndertime te urave, kanalizimeve, rrugeve e trotuarve deri

me vendosjen e dritave ne trotuar sic eshte investimi ne fshatin Ishull-Shengjin. Keto arrije jane bere ne saje te nje administrate te perzgjedhur e te mire arsimuar, te perkushuar per punen. Disiplina e forte ne pune dallohet ne hyrjet e daljet e punonjeseve qe behen me me rregull se ne dikasteret qendrore.

Sapo te afroresh Komunes Shengjin te binde se je para nje institucioni shtetror. Organizimi e drejtimi jane art me vete, por keto nuk mangujne ne drejtimin e kesaj Komune. Per hallet e problemet qe ka komuniteti tani zgjidhen sipas ligjit, pa sorollatje e brenda afateve te percaktuara dhe me transparence te plote.

Keto ju kane rritur optimizmin njerzeve dhe nuk ngurojne te investojne, jo vetem ne qytet por edhe ne fshatra e lagje. Raste ka shume, por ne po ndalemi ne lagjen e "Shaljanve" ku jane ne nderitim e siper me dhjetra shtepi dy, tre e katerkatshe. Ne kete lagje jane bere e po behen edhe investime te shumta te cilat e kane hijeshuar pamjen e kesaj lagjie. I tille eshte inagurimi i kompleksit te quajtur "Riviera" ne prag te hapjese se sezonit turistik. Investim i bere nga z. Arben Fusha, nje kompleks qe do ta kishin lakmi edhe qytetet e medha. Ne kete kompleks me pishina per te vegjel e te rritur, parking te garantuar, kamping, kend lojrashe e bar e motel pa haruar edhe kalçeto, ku sherbehet me kulture te larte, fale nje stafi te perzgjedhur mire. Investim modern, ka bere edhe kengetari i mirenjohur Zef Beka. Keto investime jane shtuar atyre ekzistuese sic jane Bar-Restaurant-Hotel "NIKOLA", Bare-Restaurant "ATHINA" e te tjera. Investime po bejne edhe emigrantet e kthyer, siç eshte rasti Leke Rrok Ivanaj, i cila ka hape nje biznes per prodhimin tubave plastik. Nje objektivi i Kryetarit te Komunese, eshte edhe sigurimi i kushteve lehtesuese per investime qe do bejne emigrantet e kthyer ne vend, me qellim hapjen e sa me shume vende pune per banoret e kesaj komune.

Per ndryshimet ne Shengjin folen edhe tre ish-Presidentet e tre Shteteve Ballkanike, qe ishin per vizite ne kete qytet, ku analizuan arrijtet dhe ndryshimet radikale te bera ne nje vit ne Komunen e Shengjinit. Me te drejte u tha se Shengjini "BASHKON BALLKANIN". Pra ky ishte nje promovim i arrijtjeve.

Nga **NDUE ZIÇI**

## Gjakmarrja, plagë ende e pambyllur

Sa herë kam parë ëndërr duke e shpëtuar atë njeri dhe po aq herë jam zgjuar i djersitur nga vetëdija se nuk isha aty, se nuk munda të bëja gjë, se nuk... Qysh atë ditë e kam të vështirë të kaloj andej pa rregulluar frymëmarrjen. Ndodhi në mes të ditës e bash në rrugën kryesore të qytetit. Si zakonisht vijonin rrugën kalimtarë, çifte të reja pëshpëritnin fjalët e tyre, fëmijë lëshonin tinguj gazmorë. Para shënjestrës u vu e gjithë qytetaria. Prita në të vërtetë nuk iu zu thjesht mikut e vëllait tonë, por gjithë shoqërisë njerëzore, zinxhirit të jetës, lirisë aq të vyer. Sërish Shkodra, liria dhe kultura e saj e përfolur, u përplasën përtokë, pa frymë, dhunshëm, përgjakshëm. Që nga ajo ditë sfida është: unë dhe ti, a mund të fshihemi unë e ti pas indiferentizmit të filxhanit të kafesë?!

Para 2 vjetësh u vra në Shkodër Dritan Prroj, pastori i kishës ungjillore "Fjala e Krishtit".

\*\*\*

Grupimi i disa OJF-ëve nën emërtimin "Aleanca për Jetën", i cili ka 2 vite që operon në sferën sociale duke ngritur zërin në favor të viktimave të gjakmarrjes, më 8 Tetor organizoi eventin e radhës të titulluar "Gjakmarrja, plagë ende e pambyllur". Organizimi i një veprimtarie të tillë ishte kaheër ndër mend për koordinatorët pasi data në fjalë, në një aktivitet të mëparshëm të grupimit, ishte propozuar nëpërmjet një peticioni publik që të shpallej si dita kombëtare e luftës kundër gjakmarrjes. Qëllimi i takimit ishte homazhi ndaj figurës së pastorit dhe thirrja për të ulur krah njëri-tjetrit të gjitha shtresat

e shoqërisë sipas detyrimeve legjitime në front kundër dukurisë.

Përmes vrasjeve intensive të muajve të fundit, kundërt gjithë përpjekjeve tona si individuale ashtu edhe në grup, vdekja sikur po na qeshte në turinj duke na thënë se i kotë është munda juaj, unë këta njerëz i kam në dorë dhe luaj si të dua me fatin e tyre. Por inkurajim i madh qe dekreti shembullor i Metropolitë Katolike të Shkodrës, Sapës dhe Lezhës për shkishërimin e të gjithë atyre që vrasin apo marrin gjak. Kjo nxiti një a dy ditë më pas vetë kryeministrin e vendit të dënnon-



te me fjalë vrasjet për gjakmarrje duke njohur më në fund indirekt dukurinë e mohuar dhe të minimizuar për hir të vitrinës që Shqipëria dëshiron t'i shesë Evropës.

Në këtë atmosferë menduam të ftonim përfaqësues lokalë nga institucionet fetare, pushteti vendor, përfaqësitë e huaja, shoqëria civile, qytetarë e fëmijë të prekur nga gjakmarrja. Vetë vendosja në palkun e kinemasë ishte e tillë që, nga njëra anë u reshtuan anëtarë të "Aleancës", ndërsa nga ana tjetër figura publike që do të merrnin fjalën. Ideja ishte edhe e një vendosjeje për-

ballë njëri-tjetrit si për të thënë ku jemi dhe çfarë po bëjmë, e gjithë kjo në transparencë para publikut të pranishëm, por ndërkohë, sikurse fort bukur e vuri në pah moderatori i takimit, Luigj Mila, drejtues i Komisionit "Drejtësi dhe Paqe" nga ky ballafaqim do të krijohet një V konvencionale (anglisht victory-fitore), simbolikë ogurmire e rezultatit që arrihet kur bashkojmë forcat kundër të keqes.

Në fillim u transmetua një video e pastor Dritanit gjatë shërbesës së tij fetare. Pastaj fjalën e mori bashkëshortja e tij, Elona Proj. Me forcën karakteristike, ajo u shpreh se lufta jonë nuk është kundër njerëzve që vrasin në emër të gjakmarrjes, por kundër mendësisë mesjetare. Ajo shtoi se nuk duhet të ketë më fëmijë që jetojnë pa prindërit e tyre për shkak të gjakmarrjes dhe se askush nuk ka të drejtë të marrë jetë njerëzish. Zonja Proj, duke iu drejtuar grave, shtoi se ky fenomen ju ka marrë gjysmën tjetër të zemrës duke bërë që edhe fëmijëve t'u mungojë imazhi atëror. Arqipeshkvi Shkodër-Pult, imzot Angelo Massafra e ka quajtur dekretin e Kishës "thirrje për jetën". Ai deklaroi se ne jemi të bindur se kemi

bërë veprimin e duhur, por kërkojmë që shteti të bëjë detyrën e tij. Policia dhe shteti kanë një rol të pazëvendësueshëm ndaj duhet të marrin masa ndaj kësaj dukurie. Nuk duhet të lejohen të rinj e adoleshentë apo kushdo qoftë të lëvizin në qytet me armë zjarri. Duhet të vendoset pa hezitim dhe shume shpejt dënimi me burgim të përjetshëm për të gjithë ata që kryejnë vrasje të tilla. Pas tij, fjalën e morën edhe atë Nikoll Petani në emër të komunitetit ortodoks si dhe pastori Fitor Muça në emër të komunitetit ungjillor.

Ra në sy mungesa e titullarëve në

përgjithësi, por sidomos ajo e përfaqësuesve të komunitetit mysliman, bektashi e të Bashkisë Shkodër, ndërkohë që nderonin me praninë e tyre përfaqësues të Qarkut, Prefekturës, Prokurorisë, Gjykatës, Policisë, OSBE, EUIC, konsulli Italian në Shkodër, Roberto Andreotti.

Pastaj në emër të grupimit e të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" fjalën e mori kryetari i saj, Ndue Sanaj. Statistikat që ai sjell janë rrëqethëse: "Nga viti 1747 deri ne vitin 1909, gjatë 162 vjetëve kur trojet shqiptare vijonin të ishin nën Perandorinë Osmane, ne zonën e Dukagjinit ka pasur 82 vrasje; ndërsa në këto 22 vite në demokraci, në zonën e Dukagjinit kanë ndodhur 145 vrasje!". Interesant vëzhgimi tjetër: "Edhe në kohën e monizmit ve-proheje në formë kanunore. Për një të dënuar merrte dënimin i gjithë fafesis". Ai pohon se, sikurse gjatë periudhës së Zogut e të Enverit, këtë mendësi jo rrallë e vërejmë edhe sot në tribuna politike. Në fund, ai shtoi: "Vrasjet që bëhen sot për gjakmarrje nuk janë kanunore. Në baze të kanunit, ai që nuk është në një tym me vrasësin, ai që është i ndamë me vrasësin, pas 24 orëve nuk mbetet në gjak. Edhe pastor Dritani, në bazë të kanunit nuk do të vritej. Atë e përjashtonin 7 nene të kanunit nga pagimi i gjakut. Vrasjet ndodhin se jemi në një periudhe anarkie, të cilën shteti, në analizën time, po e lë me dashje... Mund të thonë se njerëzit me halle qeverisen lehtë! Shpresoj të mos jete e vërtetë".

\*\*\*

Një i pranishëm del përpara, merr mikrofonin dhe pa u prezantuar shpreh një dëshirë: për 100 vjetor të pavarësisë fëmijët e gjakmarrjes të nxirren nga ngujimi e të jenë përfundimisht të lirë...Dikush qeshi nën buzë. Një tjetër mendoi se fjala nuk duhet t'i jepet dokujtdo. Disa panë njëri tjetrin në sy. Ne për pak na u duk vetja si në ëndërr...

Nga **Arben Shala**



## PUSHKATIMI I 104 SHQIPTARËVE NË KAMPIN FAMEKQË TË PRISHTINËS



Nga **Burhan Bushati**, njëri nga të internuarit, sot kryetari i Organizates së Dëshmoreve, dega Shkodër

Me 23 tetor 1944, në dreke, si zakonisht bie bilbili dhe çanga, që binin papushim në mënyrë të zgjatur dhe alarmante, jo si heret e tjera. Ushtarë dhe oficer nazistë me shkopinj gome në duar vraponin drejt nesh dhe me fytyrat e tyre të egersuara diçka paralajmëronin. Të rreshtuar para tyre për pesë, ashtu të dermuar fizikisht, na detyrojnë të degjojmë emrat që oficeri nazist i lexonte nga një listë e veçantë. Ata, që degjonin emrin, i kalonin në një krah, ndërsa të tjerët tërë ankthi vijonin të degjonin zërin e tij. Edhe për mua ishte një çast dhimbjeje e madhe dhe tragjike, sepse nga rreshti në krahun e djathtë më moren vellane, Shyqyri Bushati. Çasti më i vështirë ishte kur u ndame me njeri-tjetrin, të perqafuar me mall, ne nuk do të shiheshim më në ketë jetë. Me lot në sy u perqafuam sa e kisha të vështirë të ndaheshim, por ushtari gjerman pa pyete se çlidhje kishim me njeri-tjetrin, na shkeputi me force. Gjate ndarjes më porositi: "... që të behesha i forte dhe ti thoja nënës, nëse shpëton, të bëhesh e forte se, une po pushkatohem si një antifashist, si patriot dhe atdhetar për një Shqipëri të Lire dhe të Pavarur. M'i perqafu shumë nënën, baben, vellezerit Seitin e Aline, dy motrat Hatixhen dhe Myzejenin". Pastaj në krahun e majte më moren edhe djalin e halles, Abdullah Katratin. Edhe ai më la porosi për prinderit dhe vellezërit. Pas tyre, pas meje më moren djalin e xhaxhajt, Xhemal Bushati, i cili dha porosi për motren mbasi ishte jetim. Une, naten e pushkatimit nuk fjeta asnjë ore, mbasi isha i tronditur nga gjendja shpirtërore dhe fizike. Mbas një kohe, kur u plotesua numri 104, ra

heshtja. Po, atë ditë nga kampi paaradroke marrin dhe urdherojnë 40 vete që të hapnin dy gropa të medha, diku në kodër, përballë kampit. Të interuarit e tjerë, shikonin me ankth të madh këtë gjemë që po bëhej, e cila me siguri do të përpinte jetë njerzësh. Mbasi i mbyllen në dhomen e grave, sepse grate i kishin derguar në një dhomë tjetër, gjysëm ore mbasi u errësua, ushtarët nazistë, si të ishin bisha, filluan t'i nxirrnin shokët tane dy e nga dy për ti pushkatuar, pikërisht në ato gropa që ishin hapur me duart e shoqeve tane.

Nuk dëgjohej gjë tjetër, vetëm krisma automatiku, pushke dhe mitralozi. Tmerre i vërtetë! Ndersa vazhdonte pushkimi i shoqeve, rreth 10-12 vete u munduan që të iknin nga dhoma e izolimit nëpërmjet tavanit. Nazistët e kuptuan një gjë të tillë dhe si bisha te egra hapen deren e kaushes tone dhe me revolver e automatik ne dore, na u leshuan gjithë egersi.

Komandanti nazist i kampit na drejtohej me zë të çjerre: tregoni njerezit që kane ikur, ku jane futur? Tregoni, sepse ndryshe do të ju pushkatojmë. Asnjëri nga shoket nuk e hapi gojen. Jeta e tjetrit ishte edhe e gjithsecilit nga ne. Pas kiontrrolleve të hollesishme, nazistët kapen të parin Hektor Shytin në tavan. Gjate kontrollit, kapen edhe Spiro Velkon, Musa Agollin, Kostadin Memen, Koço Boshnjakun, Xhavit Juknejn. Në atë rremuje, pa shikua listen, marrin Xhavit Juknejn dhe e pushkatojnë sa kaluan deren e hyrjes së kaushes. Në fjalet e tyre të fundit Spiro Velkoja dhe Musa Agolli, duke dale para pushkatimit, na u drejtuan me thirrjen: "Vdekje fashizmit-Liri Popullit, hakmerruni, vellezer kunder bishave te egra naziste! Mos u ligshtoni! Fitorja eshte e jona! Lamtumire shoke te dashur!" Mbasi u plotesua numri i 104 edhe me të tjerë, nuk vijoj pushkimi ite tjereve, por ne, ishim shume të pikelluar nga ai çast tragjik, me dhimbje të thelle në zemer, gëlltimim hidhërimin më të thelle për shoket që po ndaheshim pergjithmone.

Të 104 dëshmoret e Prishtinës dhe 26 dëshmoret që janë pushkatuar ngaky kamp në Morine të Kukësit, tek kulla e Lumes, kane qene, jane dhe do të mbeten përherë të pavdekshëm. Emri e kujtimi i tyre na ben apel që ta mbajme lart lavdine e antifashizmit dhe të jemi kurdohere vigjilent ndaj tërë atyre që kërkojnë të zgjojnë fantazmat e zeza të figurave të errëta të atij fashizmi e nazizmi që masakroi popujt të tërë, duke përfshire edhe bijte e popullit shqiptar.

### Lista dëshmoreve të kampit të Prishtinës:

- 1-Avni Bejko
- 2- Aleksander Jogo

- 3- Abdullah Kastrati
- 4- Abdurrahman Dibra
- 5-Bilal Konxholli
- 6- Andrea Borzikov
- 7- Dhimiter Koçi
- 8- Dhimiter Dungo
- 9- Enver Trebishti
- 10- Fani Keko
- 11- Kristo Dukoli
- 12- Kristaq Mema
- 13- Lame Koleta
- 14- Ligor Dunga
- 15- Loni Papuçi
- 16- Luçi Gallani
- 17- Ligor Tingo
- 18- Myftar Sevrani
- 19- Musa Ceno
- 20- Murat Likmurati
- 21- Fiqiri Bega
- 22- Muharrem Lami
- 23- Gjike Kuqali
- 24- Muharrem Gjashta
- 25-Shyqyri Greblleshi
- 26- Manol Basho
- 27- Hysen Kaxheri
- 28- Muhamet Tufa
- 29-Halit Lapi
- 30- Nevruz Sherifi
- 31- Hysen Palluqi
- 32- Namik Kamani
- 33-Hektor Shyti
- 34- Niko Avrami
- 35- Hysen Hakia
- 36-Osman Arifi
- 37-Hamdi Rrapi
- 38-Oresti Dilo
- 39-Haki Shehu
- 40- Pandi Foti
- 41-Hamza Shehi
- 42- Panajot Mança
- 43-Harallamb Papa
- 44-Qazmin Llazani
- 45-Ilia Baulli
- 46- Ramazan Shijaku
- 47- Ibrahim Mustema
- 48-Reshit Mustafa
- 49-Irfan Tomini
- 50- Ramazan Farka
- 51- Ibrahim Ishmi
- 52- Spiro Velko
- 53-Kristaq Boshnjaku
- 54-Sabaudin Minxolli
- 55-Kasem Balluku
- 56-Spiro Xhamballo
- 57-Kozma Andrea
- 58-Sotir Shani
- 59- Kostandin Mema
- 60- Skender Skendo
- 61-Stefo Gurra
- 62-Xhavit Juknej
- 63-Shaban Bushati
- 64- Faik Bajrami
- 65-Shaban Jegeni
- 66-Pilo Noti
- 67- Shefqet Haxhia

- 68-Xhemal Shefqeti
- 69-Shyqyri Toska
- 70- Shyqyri Bilbili
- 71- Shaban Çela
- 72-Dhimiter Mema
- 73-Tajar Gyranjaku
- 74-Shaqir Metani
- 75- Tajar Mitarja
- 76-Osman Muhaxhiri
- 77-Taahim Shehu
- 78-Sadi Petrela
- 79-Venetik Hoxha
- 80-Anastas Konomi
- 81-Vasil Llambi
- 82-Vesel Kapinova
- 83-Vasil Papingji
- 84-Theodor Acici
- 85-Vesel Sherifi
- 86-Vasil Tela
- 87-Xheladin Fishta
- 88-Xhemal Mema
- 89-Xhemal Bushati
- 90-Panajot Biri
- 91-Xhemal Abeshi
- 92-Gligor Dunga
- 93-Xhemal Fortuzi
- 94-Pandi Bode
- 95-Zyber Gjuzi
- 96-Beqir Caca
- 97-Cen Broja
- 98- Llukan Dhimitri
- 99- Ilia Kote
- 100-Hasan Zeneli
- 101-Shaban Zeneli
- 102-Gjorgji Llambri
- 103-Musa Agolli
- 104-Stefan Jovanoviç

### Nga këta të pushkatuar, 10 prej tyre janë shkodrane:

- 1-Abdullah Adem Katrati
- 2- Cen Cuf Broja
- 3- Faik Bajram Abdylly
- 4- Shyqyri Xheladin Bushati
- 5- Shefqet Sulejman Haxhia
- 6- Xheladin Sadik Fishta
- 7-Xhemal Riza Bushati
- 8-Xhavit Fetah Juknej
- 9-Qazim Fetah Llazani
- 10- Hysen Haki Beqir

Në kete periudhe, forcat ushtarake gjermane, nga sulmet e njëpasnjëshme të ushtrive aleate Anglo-Ruso-Amerikane kudo në Evropë, në veçanti nga Fronti i Lindjes dhe ai Perendimor, po detyrohej të bënte tërheqjen e saj nëpër Shkodër, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Edhe në kampin e Prishtinës, në 15 ditëshin e dyte të muajit nëntor 1944, ushtria gjermane leshon rrethimin e kampit dhe për dy-tre dite u zvendësuan me roje të xhandarmerisë së Kosovës. Pasi, këto roje shkuan pas gjermaneve, kampistet, shoqe e shoqe shperthyen kampin dhe shumica u bashkuan me forcat partizane, ndersa të sëmuret dhe pleqte u kthyen në Shkodër.

### BAMIRESJA E BOTËS

-Kushtuar nenes Terezës-

Nji bamirese kishte bota  
Ajo ishte nane e jona  
Shpirti saj mbushun dashni  
Bekimin çoi shpi me shpi.

E vogel ishte per nga pamja  
Shum e madhe ish nga zemra!  
Dora e saje preku shum plag  
E zemra saje pikonte gjak.

Pat shum etje e shum uri  
Me u dhan jet ku kish varfni  
Çdo fjal per nanen asht e pakt  
Se jeten njerzve ja u ka zgjat.

O e lumja nane fisnike!  
Zemren fale per shum vite  
Kurr ne jet s'bane dallime  
As fetare e as etnike.

Per ty pat ransi njerzia  
Çdo jet njeri e jo pasunia  
Fjala e çmuar e asaj goj:-  
"Para Zotit, te gjith njisoj"!

Çdo dite bante mrekulli  
Lutej per t'smur e per fmi,  
Lutjet Zotit ja drejtonte  
Qe njerezimin ta shpetonte.  
Ja kushtoi jeten bamirsis  
Krishti e çoi perhere n'Paris.  
Nana-Tereza, emnin ja thone  
E gjithmon asht nejeten tone!

### KRENARIA E BABIT TIM

Krenaria e babit tim  
Jane lahuta e çiftelia  
Nga keto mora frymezim  
Prej mallit rrjedhi poezia.

Çiftelise mire i ke ra  
E folklorit i ke kendue  
Sa shum babi te kam ngia  
Muzika lindi bashke me mue.

Lahuten e lasht ke trashegue  
Nga babushi i im i shtrenjte  
Kreshnikve u knove me tela 'tu  
Qe lavdi t' kene perjete!

Shpirti jot ka veç freski  
Zeri jot kurr nuk shterron

Jeta jote plot bujari  
Si uji i bjeshkeve qe buron!

T'uroj nga zemra jetgjatesi!  
E gjith t' mirat e ksaj bote  
Ndaj sot ndjej aq krenari  
Sepse jam un bija e jote!

Nga Gjyste Lumaj



# Ti Dan je?!

## TREGIM I JETUAR

Ramadan Perhati

Kudo na shoqëron pyetja:

"Ti Dan je ?!", Lazër Preka, poet

Ishte vjeshta e tretë e vitit 2001. Përjashta shtëpisë, në mbrëmje disi vonë, frynte një erë e ftohtë, prej së cilës tundeshin degët e pemëve që u kishin rënë gjethet që gjelbëronin dikur. Qielli ishte i vrejtur dhe nga çasti në çast pritej të binte shi. Ndërsa ditë më parë, majat e maleve përreth qytetit, kishin nisur të zbardhëllheshin nga dëbora. Në këtë natë të vonë nuk prisnim të kishim vizitorë si ditë më parë. Papritmas bie zilja e derës. Zonja e shtëpisë hap derën dhe me gëzim të papërmbajtur sheh tre nipat: Ensarin, Amarinin, Mesedin dhe vajzën tonë, Edlirën, e cila u kishte hedhur krahët fëmijëve. Në ato çaste unë nuk luajta nga divani. Isha duke çfletuar me vëmendje pjesë nga "Ditari im i vonuar", që kisha filluar të shkruaja 55 vjet më parë. Fëmijët dhe vajza më përshëndetën ngrohtësisht dhe pastaj, duke më lënë në qetësinë time, u afruan tek nënë Nezihaja. Pa e zgatur, nënë Neziha mori nga biblioteka një revistë dhe me zë të ulët nisi t'u rrëfej një tregim që asaj i kishte pëlqyer. Me sa kuptova, tregimi qe shumë interesant, gjë që e kuptova se të tre nipat e mi, gjatë leximit, nuk flisnin, por dëgjonin me vëmendje të madhe. Kuptimin e atij kallzimi unë e mora vesh kur nëna u bëri atyre përmbledhjen e tij. Përmbajtja qe e thjeshtë, por me vlera jo të pakta. Në të flitej për një bisedë me Zotin që një fëmijë kishte bërë sapo do të lindte. Foshnja i drejtohej Zotit: Kush do të më mësojë mua të flas, të ushqehem, të vishem, të nxë, të sillem mirë me shokët, të punoj, të bëhem i aftë për veten e familjen, t'i shërbej me punën time Atdheut, e të tjera pyetje si këto. Zoti i përgjigjej fëmijës që sapo lindej se Ai do të dërgonte pranë tij një Engjëll, që do ta ndihmonte dhe të kujdesej për të gjitha ato pyetje për gjatë gjithë jetës. Fëmija përsëri i kërkon Zotit t'i thoshte se si e kishte emrin ai Engjëll e Zoti i përgjigjet se ai Engjëll e ka emrin NËNË!

Të tre nipat iu hodhën në qafë duke e përqaftuar me plot dashuri si ngaherë ...

Mesidi, nipi i vogël, më drejtohet mua: "Po ti gjysh, a do të na rrëfesh ndonjë tregim po aq të bukur sa ky që na tha nënë Nezi?"

Mesidi ma mbylli "Ditarin"... që po këndoja, i zhytur në mendime ...

Pa dashje ai hapi Ditarin dhe lexoi aty një si titull "Zemra e nënës, ti Dan je?!"

-Të lutem, -më tha Mesidi, -na trego diçka për nënën tënde! Atë ne e kemi njohur vetëm nëpërmjet fotografive, por kjo s'na mjafton.

Dashje pa dashje u detyrova, shkurt, t'u flas diçka për nënën time të paharruar.

... Ishte viti 1956. Atëherë punoja inxhinier në kantierin e naftës, në Patos. Kisha krijuar një familje të vre. Prindërit e

mi, për shumë arsye, ndër të tjera largësia, mungesa e mjeteve të udhëtimit dhe ekonomia, nuk morën pjesë në dasmë që duhej të bëhej zakonisht. Në fakt, në ato vite, dhe në veçanti në kantieret e naftës, nuk mendonte njeri për dasma dhe nuk të kritikonte askush për dasma. Në këto kushte unë e kisha brengë në shpirt faktin që çastin më të lumtur të jetës nuk e gëzoja me prindërit, me miqtë dhe të afërmit. Këtë nuk do ta harroj kurrë

Puna në naftë qe e vështirë dhe e rëndë fizikisht, mendërisht dhe me përgjegjësi. Ajo vazhdonte pa ndërprerje, ditë e natë dhe e shpërndarë në disa rrethe të vendit. Megjithatë, për disa muaj rresht, u përpoqa të bind eprorët e mi të më jepnin disa ditë leje, që të shkoja me gruan tek prindërit e mi, të cilët ndodheshin në një nga fshatrat më të thellë malorë të Dibrës. Rruga për tek prindërit e mi ishte shumë e gjatë dhe me peripecira; kështu që gjatë udhëtimit na u desh të ndërrojmë disa automjete. Ndër to kemi provuar edhe me karrocë që tërhiqej nga kujat, madje edhe në këmbë. Gjatë rrugës fjetëm edhe përjashta, në një



lëndinë, pranë një burimi, sepse na u prish makina.

Tek shtëpia e prindërve të mi, që ndodhej e ngritur në një kodër të sheshuar, mbërritëm në orën 12 të natës. Hëna ndriçonte me rrezet e saj të arta jo vetëm livadhet, por edhe pjesën ballore të shtëpisë. Unë u afrova bashkë me gruan time tek dera e jashtme e shtëpisë dhe trokita disa herë. Nga brenda, si për çudinë time, u dëgjua një zë aq i dashur për mua. Ai ishte zëri i nënës time që më lindi, më rriti e më edukoi të isha ai që u bëra. Megjithëse kanë kaluar disa vite, ende e kam të freskët shprehjen e nënës, zërin e zemrës së saj: "Ti Dan je?"

Menjëherë, duke m'u dridhur zëri, unë iu përgjigja: "Po, nënë, unë jam ... hape derën!"

Në çast, unë e Nezihaja menduam se si kishte mundësi të ndodhte ashtu, sikur nëna po na priste tek dera. Asnjëri nuk e kishim lajmëruar nënën, as me letra e as me telefon, që në ato vite nuk kishte në fshatin tone. Ajo nuk pati dijeni se ne do të shkonim në fshat. Pyetje e nënës, "Ti Dan je", edhe në ditët më vonshme, na vinte në mendime. Si kishte mundësi

që ajo të pikaste ardhjen tonë? Zakonisht, tek prindërit e mi, që cilësoheshin si shtëpi mikpritëse dhe bujare, kur trokiste dikush në derën e shtëpisë, qoftë edhe në orët e vona të natës, porsaardhuri merrte përgjigjen "Hajde, mirë se keni ardhur!" ...

... Kanë kaluar shumë e shumë vite dhe shprehja e nënës time, - "Zemra e nënës, Ti Dan je!?", më ka shoqëruar gjithë jetën. Mesed dhe ju dy fëmijë, një ndodhi të tillë, disi të ngjashme, më ka rastisur të dëgjoj njëherë, kur isha duke udhëtuar nëpër Ukrainën e largët. Me tre specialistë rusë po udhëtoja me veturë nga qyteti i Odesës për në një qytet tjetër, në territorin e Krimesë. Ishte dimër dhe gjithkund vendi qe mbuluar me borë e akull. Degët ishin rënduar nga bora e ngrirë. Ishin vetëm rrugë të ngushta ku kalonin gomat e makinës. Gjatë ecjes, makina, nga shpejtësia, bëri një kthesë të fuqishme dhe prej kësaj ndërroi drejtimin. Ne shpëtuam për mrekulli nga përmbysja në një kanal. Ndërkohë, sapo morëm veten nga tronditja, njërit prej shokëve i bie zilja e telefonit. Pasi ai

sari dhe Amarini më kërkuan t'u kallzoja ndonjë ngjarje tjetër për nënën time. Me shumë dëshirë, unë iu përgjigja se do t'u thoshja një diçka të veçantë, por kisha frikë se do t'i shqetësoja. Dhe nisa fjalën time:

... Ju e dini se unë kam punuar dhe jetuar gjithmonë larg prindërve të mi. Të tillë e kisha profesionin. Për shkak të detyrës dhe punës, më duhej të vija tek prindërit jo më shpesh se një herë në vit. Kështu ndodhi edhe në vitet e fundit të jetës së nënës sime. Atëherë ndodhesha në një qendër pune, afër Konispolit. Më lajmëruan me tepër vonesë se nëna ime ishte e sëmurë rëndë. Ndoshta ajo kishte humbur edhe jetën, por këtë nuk ma tha njeri. U nisa, si dhe herët e tjera, me mjaft vështirësi, për t'u gjendur sa më parë pranë saj. Me dhjetra kilometra kam ecur në këmbë, rrugë e pa rrugë. Kur hyra në zonën time, çdo kalimtar që takoja, e pyesja se mos dinin gjë për nënën time. Ndonjëri më thoshte se e kisha vështirë ta gjeja gjallë. Në fakt, kur hyra brenda pragut të shtëpisë, gjeta shumë njerëz, të cilët u gëzuan se kisha vajtur bashkë

me Nazihenë. Pa u përshëndetur me të tjerët, u ula pranë shtratit të nënës dhe bashkova duart e mia me të sajat. M'u duk se më njohu. Me dorën e djathtë i përkëdhela ballin e saj. Pastaj mbështeta me lehtësi kokën pranë gjoksit të nënës sime. Pas disa çastesh, një i moshuar bërtiti se nëna Fatime ndërroi jetë. Unë, pa ngritur kokën prej gjoksit të saj, klitha dhe me zor shqiptova fjalët: "Nënë, faleminderit për gjithçka kë bërë për mua! Nuk ndërrova jetë pa dëgjuar, rrahjet e zemrës sime pranë zemrës tënde!". Kaq munda të them para nënës sime që nuk merrte frymë më.

Të nesërmen, nënën e varrosëm me ceremoni, ku morën pjesë shumë njerëz të afërm e të njohur. Në atë varrim, për herë të parë në jetën time, dëshirova të flas para aq të pranishmëve për nënën. Thashë fjalë që më dilnin nga zemra. Thashë se nëna ime ishte nëna më e mira dhe më e madhnueshmja se të gjitha nënat e botës. Sepse ajo ishte nëna ime.

Të tre nipat dhe vajza më panë se isha përplotur duke treguar dhe m'u hodhën në qafë të më përkëdhelnin. Megjithëse të vegjël, ata shqiptuan nën zë, se do të bëheshin si unë, me atë sjelljen time, edhe me nënën e tyre dhe të prekur në shpirt, u bënë gati të shkonin në shtëpinë e tyre, ndërkohë që ata bëheshin gati të largoheshin, unë u tërhoqa në qoshen time, aty në divan. Desha të pushoj paksa midis atij deti ndjenjash që më shpërtheu papritur. Zemra më rrahu fort për zemrën e nënës. Sytë m'u mbushën me lot e nisën të më rridhnin pa pushim. Në ato çaste shoh Mesedin, pa dalë akoma, i cili m'u afrua për të më pyetur pse qaja.

-Mesed i dashur, - i them, - m'u duk vetja sikur isha prapë fëmijë dhe isha pranë nënës, pranë zemrës së saj që më kishte adhuruar aq shumë! Ah, sikur të ishte kështu, djalë i shtrenjtë!

Atë natë e kalova i mbështjellë, jo në rrobat e fjetjes, por me kujtimet e ëmbla të fëmijërisë për njeriun që quhet NËNË!

# Kohë meditimesh, kohë rrethrotullimesh

Në, si nacionalitet jemi dalluar si impulsiv, reagues ndaj padrejtësive, që të tjerët na i kanë bërë dhe imponuar kur na është cënuar liria, identiteti, nderi, prona, feja e te tjetra, të cilat kanë qenë dhe janë primare për çdonacionalitet e shoqëri.

Koha ka treguar se, ne kemi reaguar në grup, por edhe individualisht, kur kemi parë dhe menduar se na janë bërë padrejtësi, që na janë shkelur të drejtat, duke mos llogaritur kundërshtarin, as koston e qëndresës qoftë ndaj pushtuesve të huaj, apo klikave dhe diktaturave që janë quajtur shqipëtare.

Por historia ka treguar që ne e kemi në gen dhe tolerancën, arsyetimin, pendimin dhe faljen, të cilat janë cilësi dhe virtyte të nacionaliteteve me kulturë e zhvillim vite e shekuj para se ne të njihemi si shtet me të drejtat dhe simbolet tona, që na kane veçuar nga të tjerët.

Kohërat, ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale, shoqërinë e venë në lëvizje, sjellin progres e zhvillim me koncepte e norma të reja, duke iu përshtatur

kohës dhe interesave për të ecur përpara. Por ndodh dhe kështu siç po shohim tek ne sot, me formacione politike të formuara shpesh nga parti me qëllime e objektiva që bien ndesh interesave të popullit, me aleanca e qeveri që veprojnë e në kualicione militantësh e të paaftësish, të cilat ndikojnë në zhvillimin e ngadalte dhe kaotik të vendit.

Në një shoqëri ku humbet besimi të institucionet e shtetit, kur sheh larg prespektivën, kur nuk gjen mbështetje te individ ose grupi shoqëror për t'u zgjuar dhe organizuar, për të kundërshtuar padrejtësitë, lind vetvetiu indiferentizmi dhe për pasojë, pesimizmi dhe monotonia e zgjatuar e me pasoja për shoqërinë.

Këto dukuri sot, i shohim të shfaqura te çdo shtresë e shoqërisë tonë. Humbja e shpresës shkakton krizë që nga individ, i cili duke mos gjetur mbështetje e rrugdalje, kalon në vetëgjyqësi, pasojat e të cilave po i shohim përmes mediave të shkruara dhe atyre vizive, të cilat nuk përmbajnë më lajm, por lajm është një ditë, që nuk dëgjojmë për vrasje, dhun-

ime, vjedhje e krime që nga më ordinerët deri te më të sofistikuarat, ku përdoren armët e zjarrit tani jo më kundër një personi por edhe grupi personash, por edhe lëndë plasëse, djegëse, bomba me telekomandë, shpërfytyrim kufomash, copimet të tyre e tjetra, që skena të tilla mund shihen vetëm në filma horrori.

Pengesat që hasën para deryve të institucioneve kur s'ke mik ose shok, te dera e spitalit, po s'pate para të gjeshe punë ose ta mbrosh vendin e punës, të marrësh pronat, të dëmshpërblehesh si i perskutuar, të kërkosh drejtësi si paraplegjik a tetraplegjik, të ngresh zërin si pensionist për rimbursim ilaçesh e te tjetra. Duhet kohë, durim e stres, të cilat stërgjaten aq sa truri mbingarkohet dhe ngjason me një rrethrotullim ku trafiku është i ngarkuar dhe rrethrotullimi të bën të sillësh rreth dhe jo të ecësh drejt, por të vonohesh më shumë.

Nga këto stresse, që prodhojnë krizë bëjnë që sot shikon njerëz që flasin me vehten e tyre, që vetvriten ose vrasin atë që kanë më afër edhe pse ndoshta është babai, vëllai, gruaja, i afërmi, i njohuri e të tjerë. Kriza te individ vjen si pasojë e krizës që ka pësuar familja, shoqëria dhe institucionet jo vetëm shetërore si gjykata, prokuroria, policia e te tjetra, por dhe ato, siç janë partitë opozitare, sindikatat, shoqatat jo fitimprurëse, të cilat janë të

shumta dhe me programe, qëllime dhe objektiva, për të ndihmuar në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë. Puna dhe influenza e tyre nuk ka qenë kurdoherë në nivelin dhe rendimentin e duhur. Për pasojë qeverisja bëhet më e lehtë dhe pushteti panvarësisht se kujt i shërben dhe interes e kujt mbron, zgjatet dhe pse shihet nga të gjithë se amortizohet dhe është e dobësuar në shumë hallka.

Të ndodhur para këtyre trysnive, njerëzit meditojnë, mermërisin me vehte, përpriqen të vetëngushëllohen e të mbijetojnë duke persëritur shpesh fjalën e urtë të popullit: "I mjeri i ligu si s'mun iku, por edhe i forti do ta gjejë belanë".

Megjithatë jeta vazhdon dhe kurdoherë do të ketë të pasur dhe të varfër, të drejtë e të padrejtë, të ketë të bindur e të pabindur, të aftë e të paftë, por shteti duhet të jetë rregullator dhe në shërbim të popullit të vet që e ka zgjedhur. Por kur shteti mbyll sytë dhe përgjumet përpara krimet e padrejtësive që po shtohen çdo ditë, populli duhet ti thërrasë me zë të lartë, ta shkud, ta zgjojë, të dijë se kë voton kur duhet ta ndërrojë pushtetin, t'ia imponojë me zërin e fuqishëm të tij se, postin do ta gëzojë po ta meritojë e do ta mbajë aq sa ta justifikojë.

Nga **Zef Bari**, kryetari i deges së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në Tiranë

## PËRËPJËKJE TË MALËSORËVE TË MALËSISË SË MADHE PËR PAVARËSINË E SHQIPËRISË



Ahmet Osja

Në fundin e shkurtit të vitit 1911, krerët e Malësisë së Madhe ishin ftuar në një takim me Krajl Nikollën në Podgoricë të Malit të Zi. Ndaj krerët e Hotit, Grudës, Kelmendit, Kastratit, Shkreliit e Rrënzave u grumbulluan në qytet dhe po përgatiteshin për takimin që do të bëhej ditën e nesërme në darkë. Papritur erdhi

lajmi që krerët po mbilleshin për të biseduar e mësuar se çfarë u kërkonte në takim Krajli. Në mesin e malësorëve kishin zënë vend një plak fisnik dhe një djalë i mençur shkodran. Djali ishte Luigj Gurakuqi, i cili e mori fjalën dhe pasi i përshëndeti prijësit malësorë u prezantoi atyre plakun e nderuar me të cilin kishin ardhur nga Triesta. Plaku ishte Ismail Qemali. Plaku u shpjegoi malësorëve se qëllimi i takimit të krajlit me ta nuk ishte i sinqertë dhe as në dobi të tyre. Krajli kërkonte as më shumë e as më pak, pr që të gjithë malësorët të firmosnin një dokument ku të dëshmohej se vullneti i tyre ishte që t'i bashkoheshin shtetit të Malit të Zi. Kjo kërkesë do të paraqitej në mbledhjen e Qeverive te Europës, duke u dëshmuar atyre vullnetin e malësorëve shqiptarë për këtë bashkim dhe pastaj Krajli do të "kujdesej" për ta duke i nënshtruar në mënyrën e tij, siç kishte vepruar edhe më parë me shumë fshatra e krahina të tjera shqiptare që i kishte shkëputur më parë "Ju do të shkoni në takim, por për asnjë

arsye nuk duhet të firmosni e të nënshkruani kërkesat e këtij krajl të pasinqertë" – u tha Ismail Qemali malësorëve. "Ai mund t'u bëjë edhe lajka dhe presione, por ju duhet të kundërshtoni kategorikisht". "Kombi ynë – tha plaku – ka flamurin e tij dhe me vrik, pasi zbertheu pulat e jelekut, nga gjoksi shpalosi flamurin kombëtar. Këtë flamur e pashë atë ditë për herë të parë, do të dëshmonte në të gjallë të tij, Mark Kolë Marku, njëri nga prijësit e fisit të Shkreliit. Me thanë të drejtën kur para nesh u shpalos flamuri dhe doli shqiptarët dykrenore, ne na u duk vetja si të ishëm zogjtë e saj dhe ashtu, në heshtje, bëmë një farë betimi, ashtu siç dinë të bëjnë malësorët.

I premtuam se porositë e tij do t'i zbatonim deri në një dhe nderin tonë dhe të flamurit do ta mbronim me gjakun tonë.

Të nesërmen erdhi Krajli. U mblodhëm në një hotel të Podgoricës. Ai erdhi dhe na dha dorën secilit dhe me një farë buzëqeshje të lehtë la të kuptohej se ishte vetë fitimtari. Pasi shumë vend në hollin e sallës filloi të flasë se ishte koha kur nuk duhej zgjatuar dhënia

E fjalës dhe firmosja e një kërkesë që malësorët duhej t'i bënin Europës për tu bashkuar me Malin e Zi. Pasi mbaroi

fjalën, malësorët njëzëri iu përgjigjen se e njihnin si prijësin e Malit të Zi, por kurrësi dhe asnjëherë nuk do të pretendonin të bashkonin fatin e tyre me të shtetit të tij. Pasi pa se ishte e pamundur t'i bindte malësorët, ai u ngriti i inatosur dhe doli nga mbledhja. Por tani ai doli jo nga dera që hyri, por nga një deriçka tjetër e në mënyrë të fshehtë u largua nga Podgorica. Malësorët morën flamurin që u dha Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi dhe u betuan për flamurin e të parëve se do t'i mbronin tokat edhe më gjakun dhe jetën e tyre. Janë këta malësorë që me 6 prill 1911 ngritën flamurin në Deçiq.

Këta burra vazhduan të gjenden në këto anë deri më 23 qershor 1911, kur në Greç të Kelmendit u mblodhën dhe zhvilluan Kuvendin e Greçës, i cili hartoi memorandumin me 12 pika që shqiptarët i drejtonin Europës dhe Portës së Lartë. Gjithë kjo është pjesë e rrugës së gjatë që ndoqën shqiptarët deri në shpalljen e pavarësisë në Vlorë me 28 Nëntor 1912.

Gjithë këto janë pjesë e historisë së popullit shqiptarë në këtë 100 vjetor të Shpalljes së Pavarësisë dhe ngritjen e Flamurit të Shtetit Shqiptar.

### KUVENDI I FANIT 1911

Ti Shqipni ke histori të vjetër  
Si një shqipe e skalitur në hekur  
E forte kje, e forte ke mbetun  
Historia të njeh ne shekuj.  
Histori pate dhe histori bane,  
T'i dha jeta si nishane  
Shume here jeta t'ka randue  
Se i huaji të ka trazue,  
Por, nacionaliteti yt i fortë ka qendru  
Me guxim mbijetove,  
Ruajte vlera, s'u asimilove.

Ju o zonat e malcise  
Rritet burrat e trimnise  
I bate balle padrejtësisë  
Ishit pishtare të lirisë

Stolisët vlerat e historisë  
Në flamurin e lavdisë.  
At e ruajtet në shpirt e në ngji  
Në beteja u ka pri  
Me fitore plot krenari  
Të dhan force edhe lavdi.

Shume here ty s'të lan rehat  
Me dredhi edhe diktat  
Ç'ka s'kish ndodhe kurrë në Shqipni  
Me të heqe fe edhe kombesi.  
Mos me të thirre ma shqiptar  
Por arrnaut pa ideale  
Me guxim shpejt vepro  
Ti padrejtësitë i kundërshtove  
More armet në male shkove.

Linde, u rrite, u forcove

Veshtiresite i përballove  
Ktheve malet në llogore  
Në keshjtella kullat shekulllore.  
Për qendresë të doli nama  
Nuk pranove grada e nishana,  
As saraje, as fusha të gjana.  
U forcove e bane jetesë  
Ktheve malet në qendresë.  
Plagë të randa të dha jeta

E forte qendrove si ato kreshta  
Nuk pagove takse as të dhjeta.  
Kontribute as nizam (ushtar)  
Marre vetit si ke lanë.  
Historine po ta studjosh,  
Ngjarje të reja do të zbulosh,  
Që kanë data historike,  
Për kuvende e kryengritje

Për malësorët ishin jetike  
Me luftra të rrepta, burra kreshnikë  
I ke gjetë prite në pritë

Me musteqe deri në vesh  
Armë të mbushuna, qemerin ngjeshë,  
Ballë për ballë me hasmin ndesh.  
Ata trima burra azgana  
Thuë për luftë i ka lindë nana.  
Për Shqipni banë mrekullina,  
Nëpër kreshta, qafa e ledina  
Me t'ndez flakë thue ra vetima  
Krishte huta, pushka e martina  
Zani dilte – "qendro se mrrina".

Pjetër Gera, Belgjikë (vijon)

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

### POEZI NGA MARTIN CAMAJ



#### FILL I GJETUN

Natën që shkoi u fiken dritat e mbeti  
qyteti në terr deri në agim.

Amvisat kerkuan llampat vojquri  
E s'i gjeten në terr.

Në nadje ra dielli e zbeu  
faqet e rrokaqiejve.

Në nadje vrejta rrethin e andrrave  
Në truall  
E gjeta fillin e tretun  
Në piken e ndaljes së drites.

#### IME AME

Shqemza e thatë dridhet  
në shakmbin mbi Dri e rrahun  
nga fryma e tërbueme në Shëndre.  
E ajo më thotë: "Je barrë e vrame  
Në parzmin tim!

Kaloje lumin para sosjes  
të dimnit!"

#### KUSH I BANI MENGJI QYTETIT?

Shi te kambët e permendores  
Në sheshin e madh te qytetit milionësh  
Gdhiu nuska e mëngjishme  
Me një pe të kuq në qafë.  
"Shej i tmerrshëm për këtë qytet!"  
Tha pastruesi i rrugeve  
nga fusha e Anadollit.  
"Shej i tmerrshëm për këtë qytet!"

#### AI MAL AKULLI NDAN KOHEN

Ai mal akulli kish një emën,  
nji emën tabu!

Para se të mbylleshin sytë në gjumë,  
Pashë malin e akullt të bardhë  
Te kambët e mia.  
Era erdhi me diell dhe e shkrini  
A aty nën hijen time doli një bimë.

#### TINGUJT E PARE

Pava ndër qiellin e vrrinit dikur  
tue kalue shumë  
dhe lumejt e turbullt tue bajtun  
gur e landë.

Tue hy në t`shtaten vjetë  
ujkun e pava në ikje me bisht ndër kambë  
e me veshë të çuem currek përpjetë.  
Shkova me njerzit e mij  
Shtigjeve te ngushta t`malit  
e pata u e et.  
Ndigjova ortiqet e bubullimen e motit  
e fjalën "mos u tremb!" tim et.

Verat e lugjeve i rrej në parzëm  
e n`fletzat e gjethit t`blerë dhe sot  
vendet e mia t`para i shoh.  
Tingujt e currilave në lagsina  
e zani monoton i pipzës feminare  
me mote n`mue janë rritë  
lule gjaku në shullaje  
pë të dalun kangë një ditë.

#### GJAKMARRJA

Vetmia ka thithë erën e bjeshkës  
dhe fije bari as fletë nuk lot.

Të mnershëm janë korbat e zez  
Në pushim mbi qarrat e vjetër  
Maje mali në vapë.

Mendja e njeriut nën hije sheston  
Udhë gjaku  
e sosjen e pagjës në mal e vrri.

#### DREKE MALSORE

Sot asht marrë një gjak.  
Dy plumba lshuen perdhe një burrë.

Sot asht marrë një gjak.

Nën tunin e spates  
Pëlset rrashta e kaut te prroni.  
(Drekë të mëdha po bahen sot!)

Sot asht marrë një gjak.

Gjama e burrave tërbueshëm  
Përzihet me eren e mishit ndër zjarme.  
E gjethi i vjeshtes bie  
i djegun mbi kapuçat e bardhë  
ndër tryeza , jashtë.

Natë.Në vorrezat mbi kodër  
Tokë e re, hanë e re.

Ujqit janë ulë prej malesh  
e pijnë gjak në prrue.

### POEZI NGA FREDERIK RRESHPIJA

#### SHTEGTAR

Hënë s`ka, yje s`ka  
Ecen vetmija me bijtë e saj.

Asnjëri s`më pret te porta, vetem trishtimi.  
Dhe trandafilat tërë ankth.  
Nata dremit te ajri i dritares.  
Atje ku syt e mi janë gdhendur në monument



pikellimi.

Hënë s`ka, yje s`ka.  
Ecen vetmia me bijtë e saj.

#### PASQYRIM

Çdo natë e ka një statujë timen brenda  
Statujat fshihen pas amalgamës.  
Ne fshihemi pas statujave.

#### VENDLINDJA E NENES

Atje hëna ngre shkallë drite mbi gremina.  
Atje ngjitet zëmëra ime  
Gatuar prej druri të lahutës.

Atje kam , në një degë lisi,  
Torbën e këngëve të mija.  
Stapi në udhë më humbi  
Dhe lulëzoi pranë një prroi.

Pashë femininë e nënës sime  
Ruajtur në pasqyrime krojesh,  
Këngët e rinisë së saj  
Shendrrue tashmë në erë.

#### VJESHTE 1990

Qan dreri në korije dhe lotet bien shi.  
Trishtohet era mbi shkëmb.  
Nuk ka gjethe te gjelbra. Po bien  
Endrrat e pyjeve një nga një.

Ikën zogjtë nga shkretimi i drurëve:  
Lamtumirë o pyje te Ballkanit!  
Veç nën një ferrë katëron enede  
Vjollca e fundit e këngës së bilbilit.

Ardhtë një vjeshtë pa shtegtim zogjsh!  
Ardhtë një Zot, vëntë dorë mbi stinët.

#### PROFETET E RREME

Dhe kemi qenë tmerrsisht të persekutuar.  
Dhe jemi biblike me biografi të mire.  
Mjer ju po i besuat çdo të persekutuari!  
Dhe vetem ne mund t`u çojmë në parajsë.  
N.q.s. s`na besoni, ne mund të marrim edhe  
masa.  
Injorantët e dreqit!  
Amen!

Përgatiti për botim **Lazër Kodra**